



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal
Komuna e Kamenicë
Datë: 12.06.2026

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z. /S. <u>01</u>	Nr./Br./No. <u>16002</u>
Nr. i faq. <u>01</u>	Data: <u>12/06/</u>
Br. Str. <u>01</u>	Datum: <u>2026</u>
No. Pg.	Date:
KAMENICË - KAMENICA	

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesja e Kuvendit me datë: 12.06.2026:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e VI-të, të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet ditën e **Hënë** me datë: **22.06.2026**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e V-të, e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kamenicës 2027-2029.
3. Të ndryshme.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRADANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z. /S.	Nr./Br./No.
Nr. i laq. Br. Str. No. Str.	Data Datum Date
01/04	15966 2106
KAMENICË - KAMENICA	

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më: 20.05.2026

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës dhe filloj ora 10:15. Në mbledhje përveç anëtarëve të pranishëm ishin, shërbimi profesional i kuvendit, zyrtari për integritet evropiane, zyrtar të tjerë komunal, përfaqësues nga OSCE. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e Komitetit për Politikë dhe Financa, Arbnore Beqiraj Fera e cila për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e IV-të, e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Të ndryshime.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal Të nderuar Anëtar dhe Anëtare të KPF-së.

Mirë se po takohemi në mbledhjen e V-të, të rregullt të këtij viti.

Konstatoj se kemi korum të mjaftueshëm për ta mbajte këtë mbledhje, Rendin e ditës dhe materialin e keni pranuar me kohë

A keni propozime për rend dite?

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, unë kam një propozim që ka të bëjë me Draft Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integritit të të huajve në Komunën e Kamenicës 2026-2028.

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për, 6

Kundër, nuk ka

Abstenim, nuk ka

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, a kemi pika tjera shitesë, nëse jo e hedhim rendin e ditës në tërësi në votim

Kush është për miratimin e rendit të ditës ?

Për, 6

Kundër, nuk ka

Abstenim, nuk ka

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar për Politikë dhe Financa

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal - jemi në pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së, a keni vërejtje apo diskutime rreth kësaj pike ?

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për: 6

Kundër: 0

Abstenime: 0

2. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e dytë është Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, a keni diskutime tek kjo pikë, fjala për:

Granit Berisha – Anëtar i KPF-së, Përshëndetje Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Unë e lexova materialin për këtë pikë. Në konfirmimin që ka ofruar drejtoria përkatëse për këtë pikë thuhet që është në harmoni me PZHK-në e vitit 2014, a është gabim teknik apo çka ka ndodh pasi që mendoj që në këtë rast është dashur të mirët PZHK e re që është miratuar në vitin e kaluar në Kuvendin Komunal, e dyta mendoj që ka qenë më e arsyeshme që para se të vij këtu të ndahet kjo parcelë prej parcelës në total pasi që po flasim diku për 5 hektar si parcelë e tërësishme ndërsa këtu janë 650 metra, ndoshta ka qenë më e arsyeshme që të parcelizohet kjo e pastaj të vij në Kuvend, e të ipet vetëm kjo parcelë se kështu vetëm po komplikohen gjërat pa pasur nevojë, nëse ka mundësi të na tregohet saktë se ku është kjo, faleminderit shumë.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, saktësisht se ku ndodhet si lokacion për arsyeje të terrenit të gjerë nuk mund të them saktë, po për këto shqetësime të cilat i ngrite do

mirësh informacione të plota në mbledhjen e kuvendit ku edhe do të trajtohet si pikë nëse jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend. Fjala për:

Magbule Kastrati – Anëtare e KPF-së, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Në çka janë bazuar që të ipet vetëm për Fitness kjo hapësirë publike dhe për mbledhjen e rregullt me sjell listën se kush është në komision. A do merë pjesë edhe Drejtori Edon Dërmaku në mbledhjen e rregullt

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, komisioni do formohet dhe votohet në kuvend në mbledhjen e rregullt ku do jenë të pranishëm asambleja komunale, nuk mund të ipet një parcelë pa pasure komision vlerësues, si dhe Drejtori Edon Dërmaku do jetë i pranishëm në mbledhjen e rregullt.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, nëse jeni dakord për trajtim në Kuvend atëherë e hedhim në votim

Kush është për miratim ?

Për: 5

Kundër: 0

Abstenim: 2

3. Draft Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integritit të të huajve në Komunën e Kamenicës 2026-2028

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika shtesë, ku për sqarim të duhur do na jep

Zijadin Thaqi – Zyrtar për Integritime Evropiane, Përshëndetje për gjithë. Unë si Kryesues i Grupit punues kemi hartuar draft planin për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, në të ardhmen parashihet edhe për azil për personat që vijnë. Drafti është përgatitur në bazë të legjislacionit në fuqi sa i përketë këtij riatdhesimi, dje e kemi mbajtur diskutimin publik dhe i kemi përfunduar gjitha proceduar e nevojshme. Për më shumë nëse nuk keni diskutime i trajtojmë në mbledhjen e rregullt do jem i hapur për sugjerime dhe komente.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për:

Jeton Biqkaj – Anëtar i KPF-së, mendoj që bashkë me materialet duhet të na vijnë edhe procesverbalet e dëgjimeve publike dhe kjo të jetë si një praktikë për të ardhmen.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera, pasi që nuk ka e hedhim në votim

Kush është që kjo pikë të shkoj në kuvend ?

Për: 7

Kundër: 0

Abstenim: 0, kalon.


4. Të ndryshme

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal - a keni diskutime në pikën të ndryshme, a e dëshiron dikush fjalën për diskutim ?


Nëse jo, e konstatoj të mbyllur takimin e sotëm.

Mbledhja përfundoj në ora: 10:25

Procesmbajtëse


Violeta Krasniqi


Kryesuese e Kuvendit Komunal


Arbnore BEQIRAJ FERA





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



ZAPISNIK

Sa pete (V) sednice Komiteta za Politiku i Finansije održanoj: 20.05.2026

Sednica održana u opštinskom objektu i počela u 10:15. Na sednici osim članova, prisutni bili, stručna skupštinska služba, službenik za evropske integracije, ostali opštinski službenici, predstavnik OEBS-a itd. Sednicu otvorila i predsedavala Predsedavajuća Komiteta za Politiku i Finansije, Arbnore Beqiraj Fera koja za sednicu predložila sledeći:

Dnevni red

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa IV-e sednice Komiteta za Politiku i Finansije.
2. Predlog odluke za davanje na kratkoročno korišćenje Opštinske nepokretne imovine.
3. Razno.

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine Poštovani Članovi KPF-e,
Dobrodošli na V-oj redovnoj sednici za ovu godinu.

Zaključujem da imamo dovoljan kvorum za održavanje ove sednice, dnevni red i materijal ste na vreme dobili.

Imate li predloga za dnevni red?

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, ja imam predlog koji se odnosi Nacrt Opštinskog Plana za Održivu Reintegraciju Repatriranih Lica i Integraciju stranaca u Opštini Kamenica za period 2026-2028.

Ko je za, da se ova tačka uvrsti u dnevni red?

Za, 6

Protiv, nema

Uzdržano, nema

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, ima li dodatnih tačaka, stavljam celi dnevni red na glasanje,

Ko je za usvajanje dnevnog reda?

Za, 6

Protiv, nema

Uzdržano, nema

**1. Razmatranje i usvajanje Zapisnika sa prošle sednice Komiteta za Politiku i
Finansije**

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine – nalazimo se kod prve tačke dnevnog reda, Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prošle sednice KPF-e, ima li primedbe na zapisnik?

Ko je za usvajanje ove tačke?

Za: 6

Protiv: 0

Uzdržano: 0

**2. Predlog odluke za davanje na kratkoročno korišćenje Opštinske nepokretne
imovine**

Arbnore Beqiraj Fera -- Predsedavajuća Skupštine Opštine, Druga tačka je Predlog odluka za davanje na kratkoročno korišćenje Opštinske nepokretne imovine, ima li diskusije kod ove tačke, reč ima:

Granit Berisha – Član KPF-e, Pozdrav Predsedavajuća, pozdrav svima vama. Materijal po ovoj tački nisam pročitao. U potvrdi koju je dostavilo dotično odeljenje po ovoj tački, kaže se da je u saglasnosti sa ORP-e iz 2014 godine, da li je tehnička greška ili šta se dogodilo, jer u ovom slučaju trebalo bi uzeti ORP-e koji je prošle godine u Skupštini opštine usvojen. Drugo, mislim da bi bilo razumnije da pre nego što se pojavi ovde da se ova parcela odvoji od celokupne parcele pošto govorimo za oko 5 hektara kao celokupna parcela, dok se ovde nalaze 650 metara. Možda bi se opravdalo da se to podeli posle da se na Skupštinu pojavi, i da se daje, jer ovako se stvari bez potrebe samo se usložnjavaju. Ako je moguće da se tačno kaže gde se nalazi ova parcela, hvala vam puno.

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, zbog raspotranjenog terena ne mogu vam tačno reći gde se ova parcela nalazi. O ovim zabrinutostima koje si izneo, potpune informacije ćeš dobiti na sednici Skupštine, gde će se i razmotriti ova tačka koja će biti na dnevnom redu na Skupštinu. Reč ima:

Magbule Kastrati – Član KPF-e, Hvala Predsedavajuća, pozdrav svima. Koji je osnov za davanje ovog javnog prostora samo za „Fitness“, za redovnu sednicu Skupštine tražim da se dostavi spisak članova komisije. Hoće li učestvovati na redovnoj sednici i direktor Edon Dërmaku.

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, komisija će se formirati i glasati u skupštini na redovnoj sednici, gde će prisutni biti odbornici Skupštine opštine. Parcela ne može da se daje dok nema formirane komisije za procenu, kao i direktor Edon Dërmaku biće prisutan na redovnoj sednici.

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, ako ste saglasni za obradu za u Skupštinu, onda stavljam na glasanje,

Ko je za usvajanje?

Za: 5

Protiv: 0

Uzdržano: 2

3. Nart Opštinskog Plana za Održivu Reintegraciju za Reptrirana Lica i Integraciju stranaca u Opštini Kamenica za period 2026-2028

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, nalazimo se kod dodatne tačke, potrebne informacije će izneti,

Zijadin Thaqi – Službenik za Evropske Integracije, Pozdrav svima. Ja, kao Predsedavajući radne grupe, napravili smo nacrt plan za održivu reintegraciju za repatrirana lica. Uбудuće je predviđeno i za azil za lica koja dolaze. Nacrt je pripremljen na osnovu važećeg zakonodavstva, kada se radi repatrijacije. Juče smo organizovali javnu raspravu i sve postupke koje su potrebne, završili. Za više detalja ukoliko nema diskusije, obradićemo na redovnoj sednici i biću otvoren za sva pitanja, sugestije ili za komentare.

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, reć je za:

Jeton Biqkaj – Član i KPF-e, mislim da uz materijal treba da nam se dostave i zapisnici sa javnih rasprava, i to da bude za ubuduće kao praksa.

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine, ima li drugih diskusija, pošto nema stavljam na glasanje.

Ko je za, da se ova tačka prosledi za skupštinu na razmatranje?

Za: 7

Protiv: 0

Uzdržano: 0, prolazi.

4. Razno

Arbnore Beqiraj Fera - Predsedavajuća Skupštine Opštine – ima li diskusije u tački razno, želi li neko uzeti reč za diskusiju?

Ukoliko nema, zaključujem zatvorenom današnju sednicu.

Sednica završena u 10:25 časova


Prevod: Rexhep Ibrahim

Zapisničarka


Violeta Krasniqi


Predsedavajuća Skupštine Opštine


Arbnore BEQIRAJ FERA




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

REFERENC-Ë:					
PËR/ZA/TO:		Kryetarin e Komunës - z. Kadri Rahimaj Kryesuesen e Kuvendit Komunal - znj Arbnore Beqiraj Fera			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Drejtores e DFB-së - znj. Ardita Dërmaku 			
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:		KAB-Komunal 2027-2029			
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. Kancelarije:		Lokacija:		Datum:	01.06.2026
Room No:		Extencion:		Date:	
Për aktivitet/Za aktivnost/For action/					
Për miratim/Za usvajanje/For aprova/					x
Për nënshkrim/Za potpis/ For signature/					
Për komente/Za komentare/For comments/					
A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss/					
Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention/					
Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/					
Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/					
Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/					
Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/					
Afati/ Rok/Deadline/					

Të nderuar,

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029, si dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Kuvendi Komunal shqyrton dhe aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), e publikon në faqen zyrtare të komunës dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit në MF deri me datë 30.06.2026.

- Zyrtari Kryesor Financiar harton Draftin e KAB-it komunal, më pas Kryetari e dorëzon në Kuvend Komunal për diskutim Publik
- Konsultimet do të mbahen me komunitetin dhe palet kyqe të përfshira, përfshirë këtu takimet publike për të diskutuar lidhur me prioritet dhe strategjinë e Komunës.

- Kuvendi Komunal shqyrton dhe Aprovon KAB-in Komunal
- KAB-i komunal i aprovuar publikohet dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit Komunal/MF

Ju falënderit për bashkëpunim!



Korniza Afatmesme (Buxhetore) e Shpenzimeve 2027 - 2029

Kamenicë, Qershor 2026

kamenica@rks-gov.net

Përmbajtja

HYRJE.....	3
<i>Korniza e përgjithshme</i>	3
Bshkerenditja e aktiviteteve te qeverisë komunale për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2027 - 2029	4
<i>Orientimet Strategjike.....</i>	5
KORNIZA FISKALE	6
PARISHIKIMI I RREZIQEVE.....	7
<i>Perspektiva e Politikave Fiskale.....</i>	8
BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2027 - 2029	9
<i>Burimet e financimit komunal për vitin 2027 - 2029</i>	10
<i>Granti i përgjithshëm</i>	12
<i>Granti specifik për Arsim parauniversitar 2027.....</i>	12
<i>Granti specifik për Shëndetësi primare</i>	13
<i>Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2027 - 2029.....</i>	15
<i>Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2027 - 2029.....</i>	16
Buxheti 2027.....	17
Buxheti 2028.....	18
Buxheti 2029.....	19
<i>Zyra e Kryetarit.....</i>	20
<i>Zyra e Kuvendit Komunal</i>	22
<i>Drejtoria e Administratës dhe Personelit.....</i>	23
<i>Drejtoria për Buxhet dhe Financa.....</i>	26
<i>Drejtoria e Shërbimeve Publike,Ambient dhe Inspektorat.....</i>	29
<i>Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim + Zjarrfikëset.....</i>	31-31
<i>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.....</i>	37
<i>Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi.....</i>	40
<i>Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedis</i>	43
<i>Drejtoria e Investimeve Kapitale</i>	45
<i>Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale</i>	48
<i>Shërbimet Sociale.....</i>	50
<i>Shërbimet Rezidenciale</i>	53
<i>Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....</i>	55
<i>Perkrahja e Rinisë.....</i>	56
<i>Drejtoria për Arsim dhe Shkencë.....</i>	57
PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)	59

HYRJE

Korniza e përgjithshme

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027 - 2029 si dokument i rëndësishëm dhe më kryesor paraqet koordinimin dhe ndërlidhjen funksionale në mes të prioriteteve të përcaktuara të qeveris me dokumentet strategjike komunale për zhvillim në njërin anë si dhe përfshirjen e tyre konkrete e specifike në projeksionet buxhetore për periudhën afatmesme. Duke u bazuar në këto kritere themelore që përfshijnë aspektet e menaxhimit të financave publike, ato fiskale, ekonomike dhe të barazisë shoqërore është konceptuar edhe Deklarata e Prioriteteve të Qeverisë komunale konform edhe të dokumenteve Strategjike komunale për zhvillim. Prioritetet e Qeverisë Komunale të Kamenices si pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në nivel të Republikës së Kosovës: 2027 - 2029, janë të **orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, infrastrukturës komunale, sektorit të arsimit, kulturës, rinisë dhe sporteve, sektorit të shëndetësisë primare, atë të bujqësisë, mjedisit** etj. Barazise gjinore në komunën tona është dhënë prioritet andaj do të mirret parasysh në secilin nga sektorët e lartpërmenduar. Prioritetet afatmesme 2027 - 2029, bazohen në Programin e Punës së Qeverisë Komunale dhe prioritetet e saj dhe Strategjinë e Zhvillimit Socio - Ekonomik Lokal për këtë periudhë. Strategjia për zhvillimin ekonomik lokal në komunën e Kamenices është një dokument që thekson resurset dhe pasuritë e Komunës nga e cila dalin edhe projektet konkrete për realizim. Përgatitja e Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal ka për qëllim që të shërbejë si instrument për një planifikim të proceseve të zhvillimit lokal me gjithë përfshirje, për planifikimin e buxhetit komunal, për mobilizimin e mjeteve financiare, dhe resurseve humane si dhe koordinimin e ndihmave në të dy nivelet, atë lokal dhe qëndror.


Me Qarkoren e parë buxhetore nr.2027/01, të datës 15.05.2026 të lëshuar nga ana e MFPT, janë caktuar limitet e para buxhetore për Komuna për periudhën 3 vjeçare: 2027 - 2029 në mesin e të cilave edhe për Komunën e Kamenices. Në procesin e realizimit të prioriteteve të Qeverisë komunale rëndësi e veçantë i kushtohet qëndrueshmërisë buxhetore dhe projeksioneve makro-fiskale për periudhën afatmesme. Në këtë drejtim do të punohet që të vazhdohet me ritmin e ngritjes së vazhdueshme të investimeve kapitale, pastaj të ruhet stabiliteti buxhetor, ngarkesë me të ultë të bizneseve me tatime si dhe rritja e nivelit të grumbullimit të hyrave vetanake. Komuna e Kamenices do të inkurajojë, mbështesë, bashkërendojë dhe koordinojë me efikasitet politika, aktivitete e burime që i kontribuojnë prosperitetit e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunës, fuqizimit të biznesit dhe sipërmarrjes, për një mirëqenie më të lartë njerëzore. Ky dokument është baza për përcaktimin e sektorëve me prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2027 - 2029. Ky plan i integruar nuk zëvendëson plane tjera por sigurohet që të gjitha plan programet dhe projektet tona të jenë të kanalizuar dhe të paraqesin dinamikën dhe strategjinë e zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të Komunës sonë në tre vitet e ardhshme. Objektivat e përcaktuara në KASH do të zhvillohen në aktivitete dhe projekte konkrete përmes procesit të rregullt buxhetor. Duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2021 – 2025, Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve, si dhe Planet individuale Operacionale të Departamenteve përkatëse, duke pas prioritet që Komuna e Kamenices do të arrijë që të krijojë një kornizë e cila do të shpejtojë zhvillimin ekonomik duke siguruar një ambient të sigurtë dhe atraktiv edhe për investitorët.

Bashkerenditja e aktiviteteve te qeverisë komunale për kornizën afatmesme të shpenzimeve 2027 - 2029

Duke vlerësuar prioritetet e Qeverisë si një baze të mirë nga e cila nisët zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik edhe për Komunën tonë, prioritetet tona për tre vitet e ardhshme janë të fokusuara në disa prioritetet e rëndësishme:

- *Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, krijimi i një ambienti të favorshëm për të operuar biznesi, si dhe rritja e vendeve të reja të punës.*
- *Qeverisje të mirë, disiplinë financiare, lirinë e shprehjes, autonominë dhe qasjen e barabartë në shpërndarjen e të mirave publike dhe shërbime sociale për të gjithë komunitetet pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, mosha, orientimi seksual, origjina, të ardhurat ose pasuria, gjuha, feja, bindjet, opinionet, shëndeti ose paaftësia.*
- *Zhvillimi i resurseve njerëzore, rritja e standardit jetësor, ngritja e cilësive në arsim, mirëqenies sociale për banorët e Komunës së Kamenicës*

Foto



Harta e pozicionit gjeografik të Komunes së Kamenicës, e shtrirë në pjesën Lindore të Kosovës

Kamenica është Komunë e bashkejetesës, e sigurisë dhe stabilitetit, me një ekonomi që ka nevojë të zhvillohet dhe të jetë me konkureshë, një Komunë e sigurt që promovon tolerancën, barazinë, arsimin cilësor, gjithëpërfshirjen, bujqësinë, kulturën, sportin dhe turizmin, një qytet që duhet të jetë me atraktiv për investitor në të cilin ne duam të jetojmë, qytet i pastër dhe i gjelbërt, që krijon një ambient të qëndrueshëm mjedisor për të gjithë banorët e saj.

Orientimet Strategjike

Kamenica është një Komunë që synon, rritjen e mirëqenies dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së grave dhe burrave pa dallim përmes zhvillimit të NVM-ve, rritjes së investimeve kapitale nga buxheti qendror, buxheti komunal dhe donacionet në lëmit e infrastrukturës, turizmit, bujqësisë, kulturës, sigurimit të cilësisë në arsim si dhe të shërbimeve shëndetësore dhe administrative.

Zbutja e varfërisë përmes zhvillimit të bujqësisë; ofrimin e mundësive të barabarta në qasjen në infrastrukturë, shkollim cilësor, promovim të turizmit, jetesë të shëndtshme, ambient të pastër, dinamizim të jetës kulturore dhe sportive të qasshme për të gjithë gratë dhe burrat e Komunës së Kamenicës

Objektivat e përgjithshme:

1. Të zhvillohet dhe të avancohet sektori NVM-ve dhe turizmit në Komunë
2. Të zhvillohen dhe zgjerohen aktivitetet e sektorit të bujqësisë;
3. Avancimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit;
4. Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës si një kusht për zhvillim lokal, hartimi i hartës zonale, krijimi i një ambienti të qëndrueshëm mjedisor dhe ngritja e nivelit të sigurisë së përgjithshme;
5. Promovimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale dhe barazisë gjinore;
6. Përmirësimi dhe avancimi i shërbimeve administrative për qytetarët dhe menaxhimi i pasurisë komunale;
7. Ruajtja dhe kultivimi i traditës kulturore dhe asaj sportive në funksion të promovimit dhe zhvillimit të turizmit të Komunës së Kamenicës

Të gjitha prioritetet e lartpërmendura do të financohen duke ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makro-fiskale dhe duke vënë si qëllim barazinë shoqërore dhe prespektiven gjinore.

Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale konform KASH-it të lëshuar në nivel të Republikës së Kosovës – MFPT-ve, gjatë muajit Maj 2026.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB-i) komunale paraqet një mekanizëm dhe një lloj kontrolli të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale (departamenteve) gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetet e tanishme dhe afatmesme të Komunës si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2027 - 2029.

KORNIZA FISKALE

Edhe pse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (sepse kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik në vend ndikon në politikat financiare komunale dhe si i tillë do të trajtohet sipas hapave të përcaktuar nga qarkoret buxhetore, prandaj Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës duhet të jetë në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2027 - 2029 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Me lëshimin e Qarkoreve buxhetore nga MFPT-ës, për këtë periudhë mund të shfaqen edhe ndryshime të limiteve, apo kufinjëve buxhetor, si dhe përcaktimin e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve (Paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale).

Në këtë kornizë definohet qartë financimi komunal nga grantet qeveritare për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitin 2028 dhe 2029 përfshirë të hyrat vetanake komunale, si pjesë integrale e KASH-it : 2027 - 2029.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027 , si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL).

Përcaktimi i shumave agregate të granteve qeveritare dhe alokimi i tyre në komunat specifike në periudhën afatmesme të bazuar nga propozim-grantet specifike nga ministritë e linjës MASHT, MSH, MAPL dhe MPMS, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar KASH-in për periudhën 2027 – 2029.

- Respektimi dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në LFPL,
- Formulat shtetërore për arsimin para universitar dhe shëndetësinë primare, për alokimin e granteve specifike në arsim dhe shëndetësi
- Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në kuadër të prioriteteve qeveritare.

Komunat, nga viti në vit kanë pasur një shkallë të rritur të decentralizmit fiskal dhe transparences. Sistemi aktual i financave komunale përbën menaxhim fiskal të avancuar, komunat kanë kompetenca të konsiderueshme për shpenzimet, kompetenca për ofrim të shërbimeve publike, autorizime për mbledhjen e të hyrave, dhe autoritet të gjerë në menaxhimin e financave publike.

Angazhimi i përgjithshëm për të përmirësuar dhe avancuar elementet kyçe të procesit të zhvillimit të buxhetit, ka kërkuar edhe disa ndryshime në formën e prezantimit të buxhetit komunal. Prandaj, jemi orientuar në aspektet kryesore të mëposhtme të procesit buxhetor:

- Shfrytëzimi i buxhetimit në nivel të programit dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të evidencës kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe

- Zbatimi i konceptit mbi planifikimin shumëvjeçar të buxhetit/kapitaleve, mallrave dhe shërbimeve dhe prezantimi i të gjithë zërave të buxhetit për vitin paraprak, vitin e tanishëm buxhetor dhe për dy vitet pasuese.

Futja në përdorim e buxhetimit kapital shumëvjeçar, përfshirë këtu integrimin e informatave për rezultatet e planifikuara në sistemin e PIP-it. Gjatë këtij viti komunat do të hartojnë për secilin program strategjinë me synimet dhe objektivat, përfundimet dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes procesit buxhetor.

PARASHIKIMI I RREZIQETVE TE MUNDSHME

- Dobësimi i aktivitetit ekonomik në vend dhe rënia e të hyrave si rezultat i ndryshimit të tregjeve në vendet e zhvilluara të Evropës, rrjedhimisht do të ndikonte edhe në Komuna, e sidomos komuna të vogla sic është Kamenica.
- Rreziku nga detyrimet kontigjente, si pasojë e vendimeve gjyqsore/përmbarimore, sidomos në fushën e arsimit.
- Nën-ekzekutimi i investimeve kapitale, proces që varet nga një sërë faktoresh.
- Rreziqet nga mos mbledhja e të hyrave dhe rritja e obligimeve shtese.
- Mos realizimi i objektivave të përgjithëshme e cila ndikon në rritjen nivelit të performaces etj.

Stafi:

Bazuar në Qarkoren buxhetore 2027/01 dhe në instruksionet e dhëna për komunën e Kamenices, për vitin 2027 nuk kemi ndonjë shkurtim të stafit sipas tabelave dhe shënimeve qarkorja.

- Në qarkore shihet se ka një rritje të grantit të përgjithëshëm në shumë 2,316,242.00 euro apo shprehur në përqindje 35.89%
- Nga tabela e të dhënave statistikore dhe shpërndarja e grantit specifik për arsimin parauniversitar për vitet 2027 kemi një zvoglim të Grantit të Arsimitt në shumë 2,250,610.00 euro.
- Nga tabela Granti specifik për Shëndetësi primare për vitet 2027-29 po ashtu shihet se ka një zvoglim në shumë 275,825.00 euro

Paga dhe shtesa -Kategoria e shpenzimeve për paga dhe shtesa është përlllogritur sipas kriterëve të kërkuara në qarkore 01/2017, ku si bazë për llogaritje është marr muaji prill 2026, edhe është përlllogaritur vlera 0,5% për përvojën e punës për shërbyesit civil, ndërsa pozitat e pa plotesuara bazuar nga paga mesatare e Kosoves dhe nga shuma e kalkuluar 40% të buxhetit. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave në buxhetin e përgjithëshëm është 67.64%

Mallrat dhe Shërbimet- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve ka një zvoglim prej 10,84% apo 264,536.00 euro, kjo për faktin se ka një zvoglim të buxhetit në krahasim me vitin e kaluar. Pjesëmarrja e kategorisë për mallra dhe shërbime në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë vitit 2026 do të jetë 14.19%, krahasuar me vitin 2026 ka një zvoglim të theksuar.

Shpenzimet Komunale-Në bazë të kufijve të caktuar nga KAB-I për vitin 2027-2029 del se komuna e Kamenicës ka bërë planifikimin e buxhetit me rritje për shkak të shpenzimeve të mëdha, sidomos kategoria për rryme (rritja e energjise elektrike) ngase ka shpenzime në ndriçime publike, pra kemi shtrirje të rrjetit të ndriqimit publik në fshatra dhe qytet. Pjesëmarrja e kategorisë për shpenzime komunale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, për vitin 2027 të jetë 299,002.35 euro, ose 1.95%.

Subvencionet Në bazë të kufijve të caktuar me KAB-it për vitin 2027-2029 del se komuna e Kamenicës nuk ka një planifikim të buxhetit të rritur krahasuar me vitin 2026, edhe pse kemi kërkesa për subvencionim për biznese të ndryshme dhe aktivitetet e planifikuara nga Grupi i grave dhe Drejtoria për Ekonomi, kërkesa për subvencionim edhe në përkrahje të bujqëve të komunës, subvencionimi në Drejtorinë për KRS për aktivitetet vjetore /manifestimet/ dhe përkrahje klubeve të ndryshme, kemi marrëveshje për shpenzime të varrimit, Aprovimi me ndryshim Rregullores së re dhe kostoja financiare e rritur sidomos shpenzimet e varrimit në 230.00€ dhe shpenzimet për gratë lehona, shpërblime në fushën e Arsimit, bursa për studenta etj.

Pjesëmarrja e kategorisë për subvencione në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës gjatë vitit 2027 do të jetë 735,000 ose 4.79%

Projektet Kapitale -Në bazë të kufijve të dalur nga KAB-i për vitin 2027-2029 del se Komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit më ultë krahasuar me vitin 2026 dhe ka një zvoglim prej 194,000.00€. Pjesëmarrja e kategorisë për Investime kapitale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë vitit 2027 do të jetë 11.42%

PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE

Sipas KASH-it të Republikës së Kosovës dhe Qarkores së parë buxhetore nr.2027/01 për Komuna të dt. 15.05.2026 dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2024, rrjedhë se Komuna e Kamenicës ka 22868 banorë, dhe nga Komisioni i Granteve – MFPT për vitin 2027 Komunës sonë iu është ndarë buxhet fillestar në shumë prej **15,329,208.00€**, nga të cilat Grant Qeveritar **8,769,138 € (57.21%)**, Granti specifik i arsimit **3,438,159.00€(22.43%)**, Granti në shëndetësi **1,743,697.00€(11.37%)**, Shërbimet Rezidenciale **220,000.00€(1.44%)** dhe të hyrat vetanake **1,158,214.00€ (7.56%)**, buxhet i cili përbën shumën prej **15,329,208.00€**, apo për **275,895.00** në total më i ulët se për vitin aktual 2026.

Tabela1. Krahasimi i Buxhetit 2026/2027

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
	Buxheti komunal 2026 (aktual)	15,605,103.00
	Buxheti i planifikuar 2027	15,329,208.00
	Ndryshimi	-275,895.00(1.77%)

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2027/01, MFPT 2026

BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2027 - 2029


Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhimit të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2027 do të planifikohet dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Prioritet për financim kanë projektet që janë të vazhdueshme që kanë filluar në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

STRUKTURA E BUXHETIT PËR VITIN 2027

Struktura e Buxhetit Komunal sipas vlerësimeve të para për vitin 2027 duket si vijon:

Tabela 2.

<i>Paga dhe mëditje</i>	<i>10,368,538,35</i>	<i>67.64%</i>
<i>Mallra dhe shërbime</i>	<i>2,225,875.00</i>	<i>14.19%</i>
<i>Shpenzime komunale</i>	<i>299,002,65</i>	<i>1,.95%</i>
<i>Subvencione</i>	<i>735,000.00</i>	<i>4.79%</i>
<i>Investime kapitale</i>	<i>1,700,792.00</i>	<i>11.42%</i>
TOTALI	15,329,208,00	100.00%



Burimet e financimit të buxhetit komunal për vitin 2027 - 2029


Burimet e financimit komunal përfshijnë: Grantet e përgjithëshme, grantet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Ndërsa gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të Komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL. Sipas Qarkores së parë nr.2027/01, të dt. 15.05.2026 të lëshuar nga ana e MFPT-ës për periudhën 2027- 2029 për Komunën e Kamenicës shumat e caktuara për financimin e shpenzimeve 3 vjeçare do të jenë në dispozicion si në tabelën më poshtë:

Tabela 3. Totali i Burimeve të financimit komunal për vitet: 2027 - 2029

Kategoritë BUXHETORE - Burimet e financimit		2026	2027	2028	2029
		Aktuali	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1	Granti i Përgjithshëm	6,452,896.00	8,769,138.00	6,268,633.00	6,755,912.00
2	Granti specifik i Arsimit	5,688,769.00	3,438,159.00	3,541,304.00	3,647,543.00
3	Granti specifik i Shëndetësisë	2,019,522.00	1,743,697.00	1,796,007.00	1,849,888.00
	Financimi për shërbimet rezidenciale(SHKPM)	220,000.00	220,000.00	200,000.00	200,000.00
4	Të hyrat vetanake komunale	1,223,917.00	1,158,214.00	1,188,791.00	1,235,472.00
TOTALI:		15,605,104.00	15,329,208.00	12,994,765.00	13,688,815.00

Grafiku i trendit të buxhetit komunal 2027-2029



Burimi: Qarkorja Buxhetore 2027/01, MFPT 2026

Granti i përgjithshëm

Komunat do të pranojnë Grantin e përgjithshëm, i cili është grant i sistemit të mbyllur dhe do ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me rregullativën ligjore. Granti i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme dhe të rëndësishme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është një burim adekuat për vendosjen e barazisë ndërmjet komunave dhe mundëson alokim të balancuar të burimeve edhe për komunitetet pakicë në komunat specifike

Shuma e Grantit të përgjithshëm është dhjetë për qind (10%) e të hyrave totale buxhetore të Qeverisë qendrore, duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelimit të kapacitetit të ulët të hyrave vetanake të komunave më të vogla, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000.00 €, minus 1 € për kokë banori ose 0 € për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë.

Indikatorët që janë përdorur për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna janë:

- ❖ Numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë për qind (89%); përmasat gjeografike të Komunës me gjashtë për qind (6%); numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy për qind (2%).
- ❖ Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar, për Shëndetësi primare si dhe financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS financohen nga Granti i përgjithshëm në komuna.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr.2027/01 për Komuna, të lëshuar nga ana e MFPT, me datë 15 Maj 2026, Granti i përgjithshëm për Komunën e Kamenicës, për vitin 2027 është paraparë në shumë prej **8,769,138.00 €**.

Granti specifik për Arsim parauniversitar 2027

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI-it për vitin 2027-2029.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriteret:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2025/2026;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;

- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
 - f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
 - g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
 - h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
 - i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
 - j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
 - k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
 - l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
 - m) Koordinatorët e cilësisë;
 - n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
 - o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- Sipas Qarkores së parë buxhetore nr.2027/01, për Komuna, të lëshuar nga ana e MFPT-se, me datë 15 Maj 2026, për Arsimin para universitar të Komunës së Kamenicës, për vitin 2027 është paraparë Granti në shumë prej **3,438,159.00 €**.

Granti specifik për Shëndetësi primare për vitin 2027

Granti specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL.

Grantin specifik për shëndetësi primare për vitin 2027 është aprovuar në shume prej 11.37% ne raport me buxhetin e tersishe komunal.

Sipas Qarkores së parë buxhetore nr. 2027/01 të lëshuar nga ana e MFPT-ës, me datë 15 Maj 2026, për Shëndetësinë primare të Komunës së Kamenicës, për vitin 2027 është paraparë Granti në shumë prej **1,743,697.00 €**.

Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2027 - 2029

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2027 bazuar, në vlerësimet makrofiskale, janë aprovuar në shumë prej 1,158,214.00 euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Projeksionet e të hyrave vetanake për secilën komunë janë bazuar në rekomandimet e komisionit të granteve, të përfshirë në raportin e Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Financimit të Komunave.

Në këtë projeksion janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme sipas faturimit të tatimit në pronë (ngarkesat tatimore në pronë dhe tokë) dhe mesatarja e tri viteve të fundit e të hyrave jo tatimore, duke përfshirë të hyrat nga gjykatave dhe gjykatat në trafik të hyra këto të cilat planifikohen nga niveli qendror.

Me Qarkoren buxhetore nr. 2027/01, për komunën e Kamenicës, për vitet: 2027 – 2029 është përcaktuar Planin i të hyrave vetanake si vijon:

- ❖ Viti 2027 1,158,214.00 €,
- ❖ Viti 2028 1,188,791.00 €,
- ❖ Viti 2029 1,235,472.00 €.

Komuna e Kamenicës ka planifikuar që të hyrat vetanake të komunës për vitet 2027 - 2029 do të jenë si në tabelën më poshtë:

Tabela: Projektionet e të hyrave vetanake 2027-2029




Tabela 4. Projektionet e të Hyrave Vetanake Komunale, për vitin 2027-2029

Komuna e Kamenicës

653

Nr.	Përshkrimi	Realizimi 2023	Realizimi 2024	Realizimi 2025	Buxheti 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
1	Tatimi në prone	445,498.45	198,355.38	438,943.00	481,693.00	516,615.00	521,782.00	524,391.00
2	Tatimi në tokë	150,494.52	101,780.51	103,170.00	120,667.00	146,007.00	146,737.00	147,471.00
3	Licencat dhe lejet	-	7,926.30	1,500.00	1,550.00	7,000.00	8,000.00	10,000.00
4	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	45,887.85	29,875.00	54,930.00	86,421.00	50,000.00	55,000.00	62,000.00
5	Taksat e pajisjeve motorike	-	77,700.50	67,000.00	67,500.00	50,000.00	60,000.00	69,500.00
6	Lejet per ndertesa	84,192.10	21,616.00	61,800.00	76,947.50	80,000.00	60,000.00	69,500.00
7	Taksat tjera komunale	85,306.25	120,396.10	73,800.00	80,000.00	85,000.00	71,000.00	73,000.00
8	Taksat për Mbeturinat							
9	Ngarkesat rregullatore							
10	Te hyrat nga qiraja	41,677.31	34,247.60	40,000.00	56,000.00	50,000.00	51,500.00	56,000.00
11	Bashke-pagesat per arsim	48,362.00	47,950.00	45,000.00	45,000.00	25,000.00	40,500.00	27,000.00
12	Bashke-pagesat per shëndetësi	58,737.40	63,371.80	56,000.00	56,000.00	35,000.00	57,000.00	65,000.00
13	Ngarkesat tjera komunale	79,984.00	7,926.30	95,000.00	15,000.00	61,092.00	14,500.00	20,000.00
14	Shitja e aseteve			5,000.00	5,000.00	5,500.00	5,500.00	8,000.00
15	Të hyrat tjera	115,574.37	22,379.57	88,729.00	128,638.50	47,000.00	97,272.00	103,610.00
Total		1,155,714.25	733,525.06	1,130,872.00	1,220,417.00	1,158,214.00	1,188,791.00	1,235,472.00

Parashikimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën 2027 - 2029

Për të pasur një pasqyrë mbi shpenzimet buxhetore të Komunës së Kamenicës sipas kategorive ekonomike buxhetore, në tabelën vijuese të këtij KAB-i, po paraqesim trendët historike të shpenzimeve për periudhën e dy viteve të kaluara: 2023, 2024, dhe buxhetin aktual 2025, me ç'rast mund të shihen shumat e mjeteve të shpenzuara buxhetore sipas destinimeve dhe pozicioneve buxhetore.

Trendet historike të financimit sipas strukturës ekonomike për Komunën e Kamenicës 2024-2026.

Tabela 5.Trendet e financimit 2024-2026

	Komuna e Kamenicës	2024 (Shpenzuar)	2025 (Shpenzuar)	2026 (Buxheti Aktual)
1	Paga dhe mëditje	10,717,383.33	9,450,840.43	10,027,900.00
2	Mallra dhe shërbime	1,772,484.33	2,347,995.56	2,440,411.00
3	Shpenzime komunale	206,759.74	261,892.80	262,000.00
4	Subvencione dhe transfere	620,588.14	883,690.94	930,000.00
5	Shpenzime kapitale	2,066,575.99	2,668,033.33	1,944,792.00
	Totali :	13,338,484.65	15,612,453.06	15,605,103.00
	Numri i stafit	1166	1154	1105

Propozimi i financimit të Komunës së Kamenicës sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për periudhën: 2027 - 2029 është si në tabelën më poshtë:

Kufijtë e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të vlerësuara për Financim për komunën e Kamenices: 2027 – 2029

Tabela 6.Kufijtë e shpenzimeve 2027-29

	Komuna e Kamenicës	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	10,368,538.35	10,169,000.00	10,200,000.00
2	Mallra dhe shërbime	2,175,875.00	1,307,765.00	1,542,815.00
3	Shpenzime komunale	299,002.65	293,000.00	301,000.00
4	Subvencione dhe transfere	735,000.00	350,000.00	470,000.00
5	Shpenzime kapitale	1,750,792.00	875,000.00	1,175,000.00
6.	Rezerva			
	Totali :	15,329,208.00	12,994,765.00	13,688,815.00
	Numri i stafit	1105	1105	1105

VËREJTJE - Shpërndarja e Buxhetit komunal për periudhën: 2027 - 2029, siç shihet edhe në tabelën e lartshënuar, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, është bërë konform limiteve buxhetore të përcaktuara me Qarkoren e parë buxhetore 2027/01, të dt.15.05.2026 të lëshuar nga ana e MFPT-ja.

Tabela 7. Buxheti 2027												
Kodi	Programi	Stafi	Pagat	Mallra dhe sherbime	Sh. Komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali				
16029	Zyra e Kryetarit	46	430,000.00	250,000.00		255,000.00		935,000.00				
16329	Adm.dhe Personeli	38	329,413.35	155,000.00			130,000.00	614,413.35				
16929	Kuvendi Komunal	22	240,000.00	8,000.00				248,000.00				
17529	Buxhet dhe Financa	26	245,000.00	10,000.00				255,000.00				
18189	DSHPAI	20	225,000.00	300,000.00	185,000.00		280,000.00	990,000.00				
18433	Zjarrefiksesat	29	350,000.00	40,000.00				390,000.00				
47029	Bujqesia	8	80,000.00	35,000.00		145,000.00		260,000.00				
48029	Zhvillimi Ekonomik	7	70,000.00	30,000.00		155,000.00		255,000.00				
65145	Kadaster dhe Gjeodezi	12	124,000.00	8,000.00				132,000.00				
66450	Planifikimi Urban-insp.	10	95,000.00	45,000.00				140,000.00				
66650	D.Investimet Kapitale	7	67,000.00	55,000.00			1,270,792.00	1,392,792.00				
73038	Administrata Shendetsi	4	40,000.00	40,000.00				80,000.00				
74750	QKMF	165	1,842,000.00	240,000.00	34,002.65			2,116,002.65				
75641	Sherbimet Socilae	12	120,000.00	15,000.00				135,000.00				
75642	Sherbimet Rezidenciale	11	80,000.00	75,000.00	10,000.00		30,000.00	195,000.00				
85029	Kulture, Rini dhe Sport	17	160,000.00	60,000.00		70,000.00		290,000.00				
85069	Perkrahja e Rinise	4	34,000.00	15,000.00		10,000.00		59,000.00				
92145	Administrata Arsime	7	64,125.00	629,875.00	70,000.00	100,000.00	40,000.00	904,000.00				
92770	Arsimi Parashkollor	51	368,000.00	55,000.00				423,000.00				
93840	Arsimi Fillor	458	4,115,000.00	70,000.00				4,185,000.00				
95040	Arsimi I Mesem	151	1,290,000.00	40,000.00				1,330,000.00				
Totali		1105	10,368,538.35	2,175,875.00	299,002.65	735,000.00	1,750,792.00	15,329,208.00				
Perqindja(%)			67.64	14.19	1.95	4.79	11.42	100%				

Vlera e kufinjëve preliminar të buxhetit për programet buxhetore komunale është e harmonizuar me vlerën e propozuar nga drejtoritë për të hyrat komunale për vitet 2027 – 2029.

Tabela 8. Buxheti 2028

Kodi	Programi	Stafi	Pagat	Mallra dhe sherbime	Sh. Komundale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
16029	Zyra e Kryetarit	46	425,000.00	90,000.00		90,000.00		605,000.00
16329	Adm.dhe Personeli	38	330,000.00	90,000.00			50,000.00	470,000.00
16929	Kuvendi Komunal	22	230,000.00	10,000.00				240,000.00
17529	Buxhet dhe Financa	26	240,000.00	10,000.00				250,000.00
18189	DSHPAI	20	220,000.00	100,000.00	175,000.00		100,000.00	595,000.00
18433	Zjarrefikusat	29	345,000.00	35,000.00				380,000.00
47029	Bujqesia	8	75,000.00	30,000.00		65,000.00		170,000.00
48029	Zhvillimi Ekonomik	7	70,000.00	20,000.00		65,000.00		155,000.00
65145	Kadaster dhe Gjeodezi	12	115,000.00	5,000.00				120,000.00
66450	Planifikimi Urban-insp.	10	90,000.00	40,000.00				130,000.00
66650	D.Investimet Kapitale	7	67,000.00	40,000.00			700,000.00	807,000.00
73038	Administrata Shendetsi	4	40,000.00	35,000.00				75,000.00
74750	QKMF	165	1,732,000.00	130,000.00	33,000.00			1,895,000.00
75641	Sherbimet Socilae	12	120,000.00	20,000.00				140,000.00
75642	Sherbimet Rezidenciale	11	80,000.00	55,000.00	15,000.00		25,000.00	175,000.00
85029	Kulture,Rini dhe Sport	17	155,000.00	50,000.00		30,000.00		235,000.00
85069	Perkrahja e Rinise	4	30,000.00	15,000.00		20,000.00		65,000.00
92145	Administrata Arsime	7	65,000.00	382,765.00	70,000.00	80,000.00		597,765.00
92770	Arsimi Parashkollor	51	370,000.00	50,000.00				420,000.00
93840	Arsimi Fillor	458	4,100,000.00	60,000.00				4,160,000.00
95040	Arsimi I Mesem	151	1,270,000.00	40,000.00				1,310,000.00
Totali		1105	10,169,000.00	1,307,765.00	293,000.00	350,000.00	875,000.00	12,994,765.00

Tabela9.

Buxheti 2029

Kodi	Programi	Stafi	Pagat	Mallra dhe sherbime	Sh.Komunale	Sbvencione	Investime Kapitale	Totali
16029	Zyra e Kryetarit	46	430,000.00	100,000.00		120,000.00		650,000.00
16329	Adm.dhe Personeli	38	325,000.00	95,000.00			75,000.00	495,000.00
16929	Kuvendi Komunal	22	237,000.00	8,000.00				245,000.00
17529	Buxhet dhe Financa	26	240,000.00	10,000.00				250,000.00
18189	DSHPAI	20	220,000.00	155,000.00	180,000.00		110,000.00	665,000.00
18433	Zjarrefikesat	29	345,000.00	45,000.00				390,000.00
47029	Bujqesia	8	80,000.00	35,000.00		90,000.00		205,000.00
48029	Zhvillimi Ekonomik	7	70,000.00	35,000.00		85,000.00		190,000.00
65145	Kadaster dhe Gjeodezi	12	125,000.00	5,000.00				130,000.00
66450	Planifikimi Urban-insp.	10	90,000.00	60,000.00				150,000.00
66650	D.Investimet Kapitale	7	67,000.00	55,000.00			950,000.00	1,072,000.00
73038	Administrata Shendetsi	4	42,000.00	30,000.00				72,000.00
74750	QKMF	165	1,722,000.00	160,000.00	35,000.00			1,917,000.00
75641	Sherbimet Socilae	12	120,000.00	25,000.00				145,000.00
75642	Sherbimet Rezidenciale	11	82,000.00	70,000.00	16,000.00		25,000.00	193,000.00
85029	Kulture, Rini dhe Sport	17	150,000.00	60,000.00		65,000.00		275,000.00
85069	Perkrahja e Rinise	4	30,000.00	15,000.00		20,000.00		65,000.00
92145	Administrata Arsime	7	65,000.00	409,815.00	70,000.00	90,000.00		634,815.00
92770	Arsimi Parashkollor	51	370,000.00	60,000.00			15,000.00	445,000.00
93840	Arsimi Fillor	458	4,110,000.00	70,000.00				4,180,000.00
95040	Arsimi I Mesem	151	1,280,000.00	40,000.00				1,320,000.00
Totali		1105	10,200,000.00	1,542,815.00	301,000.00	470,000.00	1,175,000.00	13,688,815.00

Zyra e Kryetarit

Vizioni:

Një Komunë model për Komunitet tjerë me mundësi zhvillimi me të drejta të barabarta për të gjithë gratë dhe burrat e Komunës dhe trajtimi i prioriteteve në të gjitha fushat e zhvillimit si Komunë.

Realizon mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të Komunës, kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, zbaton të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, përgatit propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të Komunës. Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e LVL-së dhe Statutit të Komunës, është përgjegjës të:

- 1. Përfaqësojë Komunën dhe të veprojë në emër të saj;*
- 2. Udhëheqë ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe të mbikëqyrë administrimin financiar të Komunës;*
- 3. Ushtrorë të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;*
- 4. Ekzekutojë aktet e Kuvendit të Komunës;*
- 5. Emërojë dhe shkarkojë zëvendësin e tij/saj;*
- 6. Emërojë dhe shkarkojë drejtorët, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;*
- 7. Organizojë punën dhe të drejtojë politikën e Komunës;*
- 8. Propozojë rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunal.*
- 9. Propozojë zhvillimin komunal, planet rregulluese dhe investuese, të propozojë buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe të ekzekutojë buxhetin e miratuar;*
- 10. Raportoë para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike – financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku një herë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës;*
- 11. Kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsiderohet se akti bie në kundërshtim me legjislacionin në zbatimin, apo interesin e komuniteteve;*
- 11. Delegojë përgjegjësi të anëtarët e Këshillit të Drejtorëve dhe të mbikëqyrë zbatimin e përgjegjësi.*

Deklarata e misionit:

Krijimi i rregulloreve të reja në harmoni me ligjet e aplikueshme, zbatimi i të gjitha dispozitave ligjore dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me qeverisjen komunale, zhvillimin ekonomik, barazisë gjinore, ngritjen e transparencës, llogaridhënies, efikasitetit të shërbimeve dhe rritjen e mirëqenies së banorëve të Komunës së Kamenicës

Deklarata e Qëllimit:

Zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Kamenicës, hapja e vendeve të reja të punës, përmirësimi i klimës së biznesit përmes inovacionit dhe subvencionimit të ndërmarrësve të rinj, arritja e nivelit më të lartë të standardit të jetës së banorëve të Komunës sonë, ngritje e nivelit të përgjithshëm të arsimit, barazisë gjinore, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, tejkalimi i problemeve për kushtet bazike të jetës dhe përmbushja e ndryshimit të qëndrueshëm të Komunës sonë. Përveq kësaj synojmë ta rrisim nivelin e performances me projekte konkrete dhe lidhur me këtë të përfitojmë fonde shtesë nga donatorët.

Tabela10. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 – 2029.

	ZYRA E KRYETARIT (16029)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	418,599.00	430,000.00	425,000.00	430,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	265,000.00	250,000.00	90,000.00	100,000.00
3.	Subvencione	270,000.00	255,000.00	90,000.00	120,000.00
4.	Shpenzime Kapitale	-			
	TOTALI	953,599.00	935,000.00	605,000.00	650,000.00
	Numri i stafit	46	46	46	46
	Burimet e financimi				
	Granti qeveritar	776,300.00	780,000.00	485,000.00	520,000.00
	Te hyrat vetanake	177,299.00	155,000.00	120,000.00	130,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Kadri Rahimaj,

Kryetar i Komunës së Kamenicës,

Zyra e Kuvendit Komunal

Misioni:

Duke u bazuar ne Ligjin e Vetqeverisjes Lokale, ligjet ne fuqi dhe Statutin e Komunes, rregullore dhe udhizimet Kuvendit Komunal, Zyra e Kuvendit duhet:

të ofrojë zbatimin e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase; 2. të organizojë punën e Kuvendit të Komunës, duke planifikuar buxhetin dhe kujdeset për menaxhimin optimal të tij; 3. kryen punët administrative dhe profesionale, duke përfshirë këtu edhe punët teknike për organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve punuese të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu edhe përpilimin e projekt akteve që i procedohen për miratim këtyre organeve; 4. të kryejë punë të tjera për të gjitha organet e administratës, duke përfshirë këtu pranimin e shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivit dhe ekspeditivit.

Deklarata e vizionit: Duke menaxhuar me buxhetin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, konform vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Kuvendit të Komunës, angazhohet që qytetarëve të komunës t'u ofrohen shërbime sa më të mira dhe më të shpejta, konform detyrave dhe përgjegjësi të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu lëshimin e dëshmimeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës, përpilimin e vendimeve të Kuvendit, ekspeditivin e akteve zyrtare e materialeve për nevojat e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, bën përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe lëndëve, arkivimin e lëndëve etj.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i punës së kryesuesit të Kuvendit është që, duke e njohur nevojën për të sjellë vendimmarrjen më afër qytetarëve, të promovojë qeverisje të mirë dhe kushte të jetesës për të gjithë qytetarët e komunës, duke avancuar një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike në Komunë. Me një menaxhim sa më të mirë të punës së Kuvendit, të organizojë sa më mirë punën e personelit të shërbimit profesional të Kuvendit, me menaxhim optimal të buxhetit të saj, të krijojë kushte për punë efikase dhe transparente të Kuvendit të Komunës dhe të trupave të tij, në mënyrë që qytetarëve, në bazë të kompetencave tona, t'u ofrohen shërbime në afatet e parapara me ligj, me pretendim që këto afate të jenë sa më të shkurtera.

Tabela 11. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	Kuvendi Komunal(16929)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	230,928.00	240,000.00	230,000.00	237,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	10,000.00	8,000.00	10,000.00	8,000.00
	TOTALI	240,928.00	248,000.00	240,000.00	245,000.00
	Numri i stafit	22	22	22	22

Informata mbi Udhëheqësinë:

Arbnore Beqiraj-Fera,

Kryesuesja e Kuvendit të Kamenicës,

Drejtoria e Administratës dhe Personelit

Misioni:

Misioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është ofrimi i shërbimeve administrative profesionale, efikase, transparente dhe të qasshme për të gjithë qytetarët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e administratës moderne publike. Drejtoria synon të avancojë vazhdimisht cilësinë e shërbimeve përmes profesionalizmit, digjitalizimit të proceseve administrative, trajtimit të barabartë të qytetarëve dhe rritjes së përgjegjshmërisë institucionale, duke ndërtuar një administratë funksionale dhe të besueshme në shërbim të komunitetit.

Situata Aktuale:

Situata aktuale në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme karakterizohet me një nivel të lartë të angazhimit dhe funksionimit efikas në trajtimin e kërkesave të qytetarëve. Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka pranuar gjithsej 6209 kërkesa nga qytetarët, prej të cilave 5351 kanë qenë kërkesa që i përkasin drejtpërdrejt fushëveprimit të Drejtorisë sonë. Të gjitha këto kërkesa janë trajtuar dhe përfunduar me sukses, në përputhje me afatet ligjore dhe standardet e shërbimit administrativ.

Po ashtu, edhe në sektorin e Gjendjes Civile është evidentuar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve të ofruara për qytetarët. Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar gjithsej 7035 dokumente të ndryshme për qytetarët, duke dëshmuar nivelin e lartë të kërkesave dhe angazhimit të vazhdueshëm të stafit për ofrimin e shërbimeve të shpejta, të sakta dhe efikase.

Objektivat dhe Aktivitetet

Objektivat Kryesore të Vitit 2027

1. Standardizimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.
2. Raportim i rregullt dhe i saktë në të gjitha instancat.
3. Forcimi i kapaciteteve të stafit dhe menaxhimi i performancës.
4. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për gjendjen civile.
5. Përgatitja profesionale e sektorit për sezonin e diasporës.
6. Rritja e transparencës dhe komunikimit me qytetarët.

1. Përmirësimi i regjistrimit të ngjarjeve të gjendjes civile

- Sigurimi i regjistrimit të saktë, të plotë dhe në kohë të lindjeve, martesave dhe vdekjeve brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
- Ofrimi i informatave të sakta dhe të qarta për qytetarët lidhur me procedurat e regjistrimit të ngjarjeve të gjendjes civile.
- Rritja e kënaqësisë së qytetarëve përmes përmirësimit të kohës së shërbimit dhe cilësisë së shërbimeve administrative.

2. Efikasiteti në lëshimin e dokumenteve të Gjendjes Civile

- Lëshimi i dokumenteve të Gjendjes Civile dhe akteve administrative brenda afateve optimale.
- Zbatimi i plotë i Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 01/2022 për dokumentet e Gjendjes Civile me QR Code, duke garantuar vërtetimin e autenticitetit.
- Zbatimi konsekuent i legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës në procesin e lëshimit të dokumenteve.

3. Rritja e performancës dhe menaxhimit të stafit

- Monitorimi i vazhdueshëm i punës dhe aktiviteteve të zyrtarëve të Gjendjes Civile.
- Përmirësimi i efikasitetit në punë dhe arritja e rezultateve më të mira në shërbime.
- Përmirësimi i kushteve të punës përmes furnizimit të zyrave me pajisje dhe mjete të nevojshme teknike.

4. Fuqizimi i bashkëpunimit institucional

- Forcimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Administrimit Publik (MAP).
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Departamentin për Regjistrimin e Gjendjes Civile dhe Agjencinë e Regjistrimit Civil (DRGJC-ARC) në kuadër të MPB-së.
- Koordinimi me sektorët e Teknologjisë Informative për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve digjitale që përcjellin punën e sektorit.

5. Përmirësimi i raportimit dhe statistikave të Gjendjes Civile

- Hartimi dhe dorëzimi i rregullt i raporteve javore, mujore dhe vjetore për aktivitetet e sektorit.
- Përgatitja e raporteve statistikore tabelore për lindjet, martesat dhe vdekjet.
- Dërgimi në kohë i të dhënave statistikore tek Enti i Statistikës së Republikës së Kosovës.

6. Zbatimi i legjislacionit dhe udhëzimeve të reja

- Zbatimi i plotë dhe në kohë i ligjeve dhe udhëzimeve administrative të reja në sektorin e Gjendjes Civile.
- Informimi dhe njoftimi i rregullt i zyrtarëve të Gjendjes Civile për ndryshimet ligjore dhe procedurale.

7. Rritja e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët

- Sigurimi i shërbimeve të shpejta, të sakta dhe transparente për qytetarët.
- Përmirësimi i qasjes së qytetarëve në shërbimet e Gjendjes Civile përmes informimit të vazhdueshëm dhe përdorimit të teknologjisë.

Tabela 12. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT(16329)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1	Paga dhe mëditje	313,727.00	329,413.35	330,000.00	325,000.00
2	Mallra dhe shërbime	180,000.00	155,000.00	90,000.00	95,000.00
3	Komunalitë	-			
4	Shpenzimet kapitale	155,000.00	130,000.00	50,000.00	75,000.00
	TOTALI	648,727.00	614,413.35	470,000.00	495,000.00
	Numri i stafit	38	38	38	38
	Burimet e Finanicmit				
	Granti Qeveritar	568,727.00	499,413.35	365,000.00	410,000.00
	Te hyrat vetanake	80,000.00	115,000.00	105,000.00	85,000.00

Informata mbi Udhëheqësinë:

Arlinda Sejdiu,

Drejtoresh e Drejtorisë së Administratës dhe Personelit,

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

1.MISIONI:

Deklarata e misionit : Drejtoria për Financa dhe Buxhet bënë menaxhimin e Buxhetit dhe Financave të Komunës, siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhim të shpenzimeve dhe informon lidhshpërndarjen komunal me aktualitetet e ndërlidhura me buxhet të komunës. Ka të punësuar gjithsejt 25 punëtor.

Drejtoria për Financa dhe Buxhet ka dy sektorë:

Sektori i Buxhetit dhe Financave

Sektori i buxhetit dhe financave bënë përgatitjen e buxhetit Brenda afateve kohore të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe prezantimin e buxhetit në KPF për aprovim dhe mirëmbanë gjitha llogaritë komunale. Për një proces buxhetor më transparent, jep këshilla për KPF mbi buxhetin komunal, menaxhon llogaritë komunale dhe raportet vjetore financiare I raportin në Kuvend, menaxhon thesarin, fondet komunale, mbikqyrë dhe monitoron sistemet dhe procedurat për implementimin e buxhetit etj.

Menaxhon të gjitha shpenzimet e komunës sipas udhëzimeve të dala nga MF, për secilin department.

Gjithashtu menaxhon Inkasimet e llogarive të arkëtueshme të taksave për ushtrim të veprimtarisë për biznese si dhe menaxhimin e qirave të pronave komunale të dhëna me qira.

Sektori i Tatimit në Pronë

Menaxhon ekskluzivisht vetëm tatimin në pronë, përgatitjen e faturave, distribuimin e faturave tatimore, inkasimin e tatimit në pronë dhe raportimin e rregullt pranë MF.

SITUATA AKTUALE

Sa i përket Tatimit në Pronë, gjatë vitit 2025 kemi realizuar 420,993.84 euro, ndërsa planifikimi ishte 542,112.96 euro, dmth se kemi realizim më pak për 121,119.12 euro.

Borxhi i përgjithshëm deri më datën 31.12.2024 është 1,539,234.56 euro, ndërsa më 31.12.2025 borxhi i përgjithshëm ishte 1,961,206.04 euro, që nënkupton se kemi rritje të borxhit për 421,971.48 euro.

Ngritja nga viti 2024 në vitin 2025 është si proces i faljes së TP nga komuna për vitin 2023 e cila u zbatua në fund të janarit 2024 e cila solli disa probleme duke ditur se të gjithë obliguesit të cilët kanë paguar për vitin 2023 kanë dal në parapagim për vitin 2024 dhe disa edhe vitin 2025..

Gjithashtu si objective ka qenë edhe realizimi i rianketimeve të objekteve ekzistuese për 20 %, mirëpo gjatë 2025 kemi realizuar 1,270 rianketime dmth kemi arritur të realizojmë vetëm 9% të rianketimeve. Arsye e mosrealizimit të 20% të rianketimeve ka qenë mosfunksionimi i programit në TP nga 27 korriku me qëllim të ndërrimit të STP . Dhe nga ajo datë deri në muajin janar pjesërisht nuk ka funksionuar STP për rianketime.

Objektivë tjetër ka qenë regjistrimi i objekteve të reja, ku gjatë vitit 2025 kemi realizuar 387 regjistrime të reja.

Rezultate kemi pasur në sektorin e taksave komunale ku gjatë vitit 2025 planifikimi për taksa komunale për shoqëritë tregtare për vitin 2025 ishte 60,000.00 €, ndërsa realizimi deri në fund të vitit arriti në 75,560.25 €.

Planifikimi për taksa nga qiraja për objektet afariste, banesore dhe tokave bujqësore për vitin 2025 ka qenë 48,000.00 euro ndërsa realizimi deri në këtë periudhë kohore është 39,631.47 €.

Duhet të theksojmë që borxhi i përgjithshëm i subjekteve afariste prej viteve paraprake deri më datën 31.12.2025 është 352,573.57 € dhe nëse e krahasojmë me vitin 2024 ku borxhi i përgjithshëm ishte 358,158.02 € kemi rënie të borxhit të përgjithshëm prej 5,584.43.

3.OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR FINANCA DHE BUXHET 2027-2029

Objektivat

- 1.Realizimi i planit të inkasimit në Sektorin e Tatimit në Pronë dhe Sektorin e Taksave Komunale
- 2.Regjistrimi i objekteve të reja dhe rianketimi 20% I pronave ekzistuese
- 3.Zvogëlim i borxheve aktuale/llogarive të arkëtueshme
- 4.Përfshirje sa më e gjerë e Buxhetimit të Përgjeshëm Gjinnor në institucion dhe analizë gjinnore nëpër gjitha drejtoritë
- 5.Fuqizimi i lidhjes ndërmjet planifikimit dhe buxhetimit
- 6.Përmisimi i menaxhimit të pasurive komunale
- 7.Fuqizimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes së raportimit dhe shqyrtimit të buxhetit;
- 8.Shtimi i kontroleve në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve:

- 1.-Organizimi i fushatave senzibilizuese me qytetar lidhur me obligimet e tyre, njoftimet e tyre me vleren, tatimin mbi tokën, njoftime gjithashtu edhe në faqen e komunës.
- 2.-Mobilizimin e zyrtarëve në teren,
- 3.-Shpërndarja e Letërkujtesave për të gjithë obliguesit,
 - Shpërndarja e Njoftimeve Përfundimtare për të gjithë tatimpaguesit që nuk i përgjigjen letërkujtesës,
 - Hartimi i kontratave për riprogramimin e borxheve për të gjithë tatimpaguesit që kanë borxhe mbi 100 euro dhe kontaktimi i palëve për cdo vonesë në pagesë
- 4.-Fushatë e re për Buxhetim Gjinnor nga praktikat dhe përvojat e fituara nga takimet dhe punëtori,
 - Një analizë e buxhetit nga aspekti gjinnor në fushën e investimeve kapitale,
 - Një analizë e buxhetit nga aspekti gjinnor në fushën e kategorisë për mallra dhe shërbime,
 - Komuna duhet të ketë një rregullore të brendshme komunale për mbledhjen e të dhënave nga aspekti gjinnor,
- 5.-Arrihet në kordinim të plotë me drejtoritë komunale

-Planifikim i mirë i buxhetit para aprovimit në Kuvend,

6.-Harmonizimi i regjistrave të pasurisë jo kapitale në mes të regjistrit të E-pasurisë dhe raportit të inventarizimit për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar plotësisht dhe saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

-Harmonizim i të gjitha pagesave në shpenzimet kapitale me regjistrin e pasurive

7. -Publikimi mujor, tremujor dhe vjetor i realizimit të buxhetit,

-Organizimi i dëgjimeve publike për buxhetin,

-Përfshirja e komuniteteve të marginalizuara në procesin buxhetor,

-Forcimi i mekanizmave të auditimit dhe kontrollit të brendshëm,

8. -Kryerja e kontrolleve periodike financiare,

-Raportim mbi vonesat dhe arsyet e tyre.

-Takime të rregullta ndërmjet financave, prokurimit dhe njësive kërkuuese për trajtimin e obligimeve,

-Raportim mbi numrin e faturave të pranuar, të paguara dhe të vonuara.

Tabela 13. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve : 2027 - 2029

	DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA (17529)	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	232,312.00	245,000.00	240,000.00	240,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	15,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00
3.	Shpenzimet kapitale	-			
	TOTALI	247,312.00	255,000.00	250,000.00	250,000.00
	Numri i stafit	26	26	26	26

Informata mbi Udhëheqësinë:

Ardita Dermaku,

Drejtoresh e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, AMBIENT, INSPEKTORAT DHE EMERGJENCA

Misioni:

Misioni i DSHPAIE është ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike duke përfshirë:

- menaxhimin e mbeturinave,
- zgjerimin e rrjetit të mbeturinave, duke i përfshi të gjitha lokalitetet e komunës,
- mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale,
- mirëmbajtje e parqeve shesheve e hapësirave të gjelbra,
- realizimi i projekteve për pastrimin e ambientit,
- pastrimi i deponive ilegale,
- sinjalizimi vertikal dhe horizontal,
- transporti lokal,
- dhënia e vijave urbane, dhe urbano-periferike,
- mirëmbajtja e ndriçimit publik,
- zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik,
- përcjellja dhe pagesa e shërbimeve komunale ,
- furnizim me ujë,
- kanalizimet dhe drenazhimet,
- trajtimi i ujërave të zeza,
- hartimi i planeve dhe rregulloreve komunale,

Situata Aktuale:

Përkushtimi aktual i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e vetëdijes tek qytetarët, si dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike. Të arriturat kanë qenë në një nivel të mirë duke pasur parasysh buxhetin si dhe numrin e stafit profesional për realizimin e projekteve.

Do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe financiare që kjo të arrihet. Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake. Ka pasur disa sfida për shkak të mungesës së buxhetit ku disa projekte nuk kanë mundur të realizohen plotësisht, psh. shtruarja e rrugëve me zhavorr, Sinjalizimi vertikal dhe horizontal, pastaj nuk ka pasur mundësi të intervenohet në disa vende ku është e nevojshme rregullimi i rrjeti të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Përafrimi i përmbushjes së një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime edhe nga donatorët.

Objektivat dhe Aktivitetet:

Zbatimi me përpikëri i planit të punës së drejtorisë për vitin 2025, ku janë të specifikuar të gjitha objektivat, aktivitetet si dhe bartësit e aktiviteteve duke zbatuar edhe afatet kohore. Qëllimi është synimi afatgjatë i cili mundë të arrihet në një moment përtej planit afatmesëm. Disa politika kanë një shtrirje shumë të gjatë kohore, dhe kjo duhet të reflektohet në periudha të më vonshme.

Tabela 14. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve : 2027 – 2029

	DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE,Ambient dhe Inspektorat(18189)	2026 Aktual	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	210,339.00	225,000.00	220,000.00	220,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	400,000.00	300,000.00	100,000.00	155,000.00
3.	Shpenzimet Komunale	165,000.00	185,000.00	175,000.00	180,000.00
4.	Subvencionet	-			
5.	Shpenzimet kapitale	311,000.00	280,000.00	100,000.00	110,000.00
	TOTALI	1,086,339.00	990,000.00	595,000.00	665,000.00
	Numri i stafit	20	20	20	20
	Burimet e financimit				
	Granti Qeveritar	986,339.00	897,000.00	535,000.00	605,000.00
	Te hyrata vetanake	100,000.00	93,000.00	60,000.00	60,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Zotrim Kastrati,

Drejtore i Shërbimeve publike,Ambient dhe Inspektorat,

Njësia për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Zjarrefikësit

Deklarata e Vizionit:

Vizioni i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim është përmirësimi i ambientit dhe krijimi i kushteve për funksionimin e institucioneve publike dhe private, për një jetë të qetë dhe të sigurt të qytetarëve, Ofrimi i sigurisë njerëzore, të kafshëve dhe bimëve, ofrimi i mjeteve në përkrahje të dëmtuarve dhe përmirësimi i kualitetit të jetesës etj.

Deklarata e Misionit:

Ky mision ka për qëllim krijimin e bazës metodologjike dhe profesionale për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve konkrete në parandalimin, zvogëlimin dhe sanimin e dëmeve të shkaktuara nga katastrofat dhe fatkeqësitë tjera të mëdha natyrore të cilat me efekt të menjëhershëm do të shkaktonin dëme në popullatën civile, pronën e tyre, në mjedisin, trashëgiminë kulturore etj.

Deklarata e Qëllimit:

Bënë koordinimin sa më efikas me drejtorinë dhe me subjekte relevante të gjitha niveleve të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe në mënyrë profesionale në rastet e fatkeqësive natyrore dhe katastrofave tjera të mundshme, si dhe koordinimi i ekipeve emergjente me subjektet përkatëse në menaxhimin e situatave emergjente. Parandalimi dhe zvogëlimi i pasojave të mundshme nga fatkeqësitë e ndryshme në kohë dhe hapësirë.

Tabela 15. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	ZJARRËFIKËSAT (18433)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	328,511.00	350,000.00	345,000.00	245,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	45,000.00	40,000.00	35,000.00	45,000.00
3.	Komunalitë	-			
4.	Shpenzime kapitale				
	TOTALI	373,511.00	390,000.00	380,000.00	390,000.00
	Numri i stafit	29	29	29	29

Informata mbi Udhëheqësin:

Riza Bunjaku,

Udhëheqës i njesisë së zjarrefikësive

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zvillim Rural

Misioni:

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka për mision zhvillimin e Bujqësisë me sektorët e saj si: Sektori i Blegtorisë, Pemëtarisë, Lavërtarisë, Perimtarisë, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura, ruajtjen dhe përpunimin e lëndës drusore, vjeljen ,ruajtjen dhe përpunimin e frutave malore, bimëve mjekuese, zhvillimin e turizmit rural, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së ushqimit me standardet e BE (ISO dhe HASAP) , rajonizimin e kulturave bujqësore, ruajtjen dhe rregullimin e tokave bujqësore dhe pyjore.

Gjendja aktuale:

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Kamenicës është 417 km² prej tyre 58 % janë tokë bujqësore, kurse 42 % janë tokë pyjore. Bujqësia në komunën tonë është sektori më i rëndësishëm pasi që pjesa më e madhe e popullatës së komunës sonë është e angazhuar në këtë sektorë. Gjendja e bujqësisë në komunën tonë karakterizohet me ferma të vogla dhe mesatare 2.2 - 2.4 ha., të shpërndarë në 7 - 8 ngastra për fermë. Me prodhimtari nën mesatare të rajonit, pa mbështetje profesionale. Mbi 70 % e popullatës jeton në zonat rurale, dhe ekskluzivisht merren me bujqësi dhe pylltari.

Drejtoria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural është e fokusuar në mbajtjen e shënimeve, statistikave të veprimtarive si në punimin e tokave bujqësore ku deri më tash në bazë të statistikave rreth 4000 hektarë janë tokë e punueshme me drithëra grurë dhe misër, ku planifikohet që të rritet sipërfaqja me ujitje. Ujitja sistem i lirë do të ndikoj në diversifikimin e kulturave bujqësore, ku një pjesë të këtyre tokave mund të kultivohen dy prodhime bujqësore brenda një viti kalendarik. Po ashtu objektivi tjetër në vitin 2027 planifikohet që të bëhet përmirësimi i racor. Objektivi i drejtorisë është edhe subvencionimi i fermerëve, si dhe ruajtja e shëndetit publik përmes projektit 2 vjeçar i trajtimit të qenve endacak ku planifikohet të bëhet menaxhimi me ta. Sektori i perimekulturës do të përkrahët me serra të vogla 1 deri në 2 ari për fermerë të vegjël.

Objektivat e drejtorisë :

- DBPZHR, në bashkëpunim me MBPZHR dhe shoqatave të huaja, i ndihmohet fermerëve në mbështetje materiale dhe profesionale.
- Daljet në teren, vizita fermerëve dhe mbajtja e trajnimeve brenda vitit 2027
- Planifikimi dhe Realizimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,
- Mbajtja e temave trajnuese për fazën pranverore,
- Dhënia e këshillave fermerëve për aplikim për subvencione në MBPZHR.,
- Takim me fermerët të organizuar nga DBPZHR rreth subvencionimit të fermerëve nga komuna.;
- Fazën e aplikimit për Pagesa direkte – Subvencione nga MBPZHR. – AZHB. - ja,
- Faza e aplikimit të fermerëve për Grante në kuadër të MBPZHR.,
- Përgatitjen e fermerëve për aplikim në Grante të MBPZHR.,
- Pastaj mbajtja e temave këshilluese për sektor të ndryshëm nga zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë,
- Në organizimin e mbajtjes së temave trajnues – këshilluese në kuadër të MBPZHR.,

- Përpilimi i raporteve të punës për departamentin e shërbimeve këshilluese në MBPZHR,
- Plotësim ndryshimi i rregulloreve komunale në lëmin e bujqësisë,
- Bashkëpunimi me organizatat e huaja ,(ndërkombëtare),
- Vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjerë sipas kërkesave të fermerëve,
- Organizimin dhe përfundimin e fushatës së Korrje-shirjeve në Komunë,
- Inicimi i projekteve nga buxheti i Komunës dhe Drejtorisë, si subvencionimi i disa sektorëve të bujqësisë p.sh: në Blegtori, Bletari, Lavërtari, Perimekulturë, Pemëtari etj.
- Fillimin, përcjelljen dhe përfundimin e projekteve nga DBPZHR,

Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit 2026;

Nr	Emërtimi i projekteve	Vlerat për vitin 2026	
		Subvencione	Mallëra dhe shërbime
1.	Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor	40,000.00 €	
2.	Subvencionimi i qumështit	50,000.00 €	
3.	Subvencionimi për sera	60,000.00 €	
4.	Subvencionim në bletari	10,000.00€	
5.	Trajtimi i qenve endacak (mallra dhe shërbime)		25,000.00€
Totali		160,000.00 €	25,000.00 €

Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit 2027;

Nr	Emërtimi i projekteve	Vlerat për vitin 2027	
		Subvencione	Mallëra dhe shërbime
1.	Subvencionimi i fermerëve në perimtari	40,000.00 €	
2.	Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor	50,000.00 €	
3.	Subvencioni i fermerëve në blegtori dhe bletari	55,000.00 €	
4.	Subvencionimi në hortikulturë	15,000.00 €	
5.	Trajtimi i qenve endacak (mallra dhe shërbime)		25,000.00 €
Totali:		160,000.00 €	25,000.00 €

Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit 2028;

Nr	Emërtimi i projekteve;	Vlerat për vitin 2028	
		Subvencione	Mallëra dhe shërbime
1.	Subvencionimi i fermerëve në perimtarë;	40,000.00 €	
2.	Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor;	50,000.00 €	
3.	Subvencionimi i fermerëve në blegtori (gjedhtari, bletari, deltari, etj);	75,000.00 €	
4.	Subvencionimi në horticulture;	15,000.00 €	
5.	Trajtimi i qenve endacak (mallra dhe shërbime);		25,000.00 €
Totali		180,000.00 €	25,000.00 €

Aktivitetet realizohen duke u bazuar në objektivat dhe planifikimin brenda vitit 2029;

Nr	Emërtimi i projekteve;	Vlerat për vitin 2029	
		Subvencione;	Mallëra dhe shërbime;
1.	Subvencionimi i fermerëve në perimtarë;	40,000.00 €	
2.	Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor;	50,000.00 €	
3.	Subvencionimi i fermerëve në blegtori (gjedhtari, bletari, deltari, etj);	75,000.00 €	
4.	Subvencionimi në horticulture;	15,000.00 €	
5.	Trajtimi i qenve endacak (mallra dhe shërbime);		25,000.00 €
Totali:		180,000.00 €	25,000.00 €

Objektivat kryesore:

1. Objektivi i DBPZHR. është përkrahja e fermerëve të Blegëtorisë (Gjedhëtarisë, Bletarisë, Shpezëtarisë dhe kafshët e imëta);
2. Përkrahja e fermerëve kultivues të drithërave si: gruri, misri, thekra, tërshëra, elbi, bimëve foragjere, bimëve industriale;
3. Orientimi i fermerëve në përzgjedhjen e farërave cilësore të përshtatshme për tokat tona;
4. Diversifikimi i fermave;
5. Orientimi i fermerëve në rritjen e sipërfaqeve të pemëtarisë;
6. Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura;

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

Aktivitetet:

Rritja e sasisë së prodhimit:

Ngritja e serave prej 1 ari dhe 3 ari;

Lehtësimi i kushteve të punës për fermerët perimtarë;

Subvencionimi i perimtarisë;

Trajnim i fermerëve lider të grupit të perimtarisë dhe vizita tek fermerët lider jashtë Komunës.

Aktivitetet – Përmirësimi i racave të lopëve qumështore:

Këshilla fermerëve blegtorë të prodhimit të mishit;

Rritja e fondit blegtoral nga 3,000 në 4,500 krerë në 5 vitet e ardhshme;

Subvencionimi i lopëve qumështore.

- **Aktivitetet**- Shtimi i numrit të fermerëve në mbarështimin e kafshëve të imta:
 - Rritja e fondit për kafshët e imta;
 - Dhënia e këshillave fermerëve mbarështues të kafshëve të imta në përmirësimin e racave të deleve dhe dhive.
- **Aktivitetet** - Menaxhimi i qenve endacak:
 - Evidentimi, matrikulimi qenve endacak;
 - Kastrimi;
 - Dehelmetizimi;
 - Mbrojtja e shëndetit publik;

• **Buxhetimi gjinor;**

Viti	Numri total i stafit;	Numri i stafit që janë gra;	Numri i stafit që janë burra;	Paga dhe mëditje/ shuma për gra;	Paga dhe mëditje/ shuma për burra;	TOTALI:
2026	7	3	3	19,206.00	19,206.00	38,412.00
2027	7	3	3	27,324.00	27,324.00	54,648.00
2028	8	3	3	32,324.00	32,324.00	64,648.00
2029	8	3	3	34,324.00	34,324.00	69,648.00

Në tabelat e më poshtme janë të paraqitura numri i përfituesve dhe shumat e shpenzuara sipas Gjinisë (Gra dhe Burra) për vitin 2026.

Shumat e shpenzuara për Gra dhe Burra nga projektet realizuara nga viti 2026.

Nr.	Pershkrimi i Projekteve	Nr.Total i Përfitues.	Shqiptar	Serb / Rom	Numri i Përfitue. / Gra	Numri i Përfitue. / Burra	% Përfitues. / Gra	% Përfitues. / Burra	Shuma totale e projekteve në /€.
1.	Subvencionim i qumështit për litër, 6M - 2/2025	82	82	0	6	76	7.32	92.68	44.442.85
	TOTALI:	82	82		6	76	7.32	92.68	44.442.85

Shumat e shpenzuara për Gra dhe Burra nga projektet e realizuara nga viti 2026.

Nr.	Emërtimi i projekteve	Shumat e shpenzuara në - Gra / €.	Shumat e shpenzuara në - Burra / €.	Shuma e Projekteve Gjithsejt në €.
1	Qumësht për lit. - 6M - 2/2025	4,701.50	39,741.35	44,442.85

Tabela 16. Performancë: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (47029)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	70,176.00	80,000.00	75,000.00	80,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	35,000.00	35,000.00	30,000.00	35,000.00
3.	Komunalitë	-			
4.	Subvencione	160,000.00	145,000.00	65,000.00	90,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	-			
	TOTALI	265,176.00	260,000.00	170,000.00	205,000.00
	Numri i stafit	8	8	8	8
	Burimet e Financimit				
	Granti Qeveritar	205,176.00	215,000.00	120,000.00	135,000.00
	Te hyrat vetanake	60,000.00	45,000.00	50,000.00	70,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Shpend Morina,

Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë

1. Misioni

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë ka për qëllim ndërtimin e kapaciteteve ekonomike të zonës lokale për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët, duke krijuar kushte të favorshme për bizneset lokale, promovuar potencialet për zhvillimin e turizmit dhe njëherit duke pasur një Diasporë shumë të fuqishme të shërbej në krijimin e urave lidhëse, përmes investimeve të Diasporës, me Komunën dhe qytetarët e saj.

Objektivat Kryesore :

Sektori: Qendra Komunale e Biznesit

1. Funksionimi i Qendrës Komunale të Biznesit duke ofruar shërbime efikase
Për të qenë funksional si sektor Qendra Komunale e Bizneseve duhet me jetë një udhëheqës dhe se paku dy punëtor pra duhet të plotësohet qendra komunale e biznesit me staf.

Sektori: Zhvillimi Ekonomik

- Përmirësimi i ambientit biznesor dhe tërheqja e investimeve të reja.
- Krijimi i qendrës për zhvillimin e sektorit privat- Ofrimi i Praktikes në punë për të rinjtë, studente, rritja e mbështetjes financiare për praktikante
- Subvencioni i bizneseve për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara,
- Monitorimi, mbikëqyrja-menaxhimi i Parkut Teknologjik për shfrytëzimin e hapësirave ndarja e zyrave);
- Planifikimi dhe përpilimi i listave të pronave të paluajtshme të komunës për publikim për dhënie në shfrytëzim në bashkëpunim me drejtorinë për prone.
- Implementimi dhe përmbushja e objektivave të parapara në Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal- Përmes komisionit të monitorimit
- Rritja e Mbështetjes për biznese start up për gratë dhe të rinjtë; Grantet LOT1 Lot 2-170,000.00 euro
- Organizmi i panairëve për promovimin e prodhimeve vendore
- Aktivitete të përbashkëta me drejtorinë për organizimin e ditëve të diasporës; DKRS
- Linjë e gjelbër për biznese të diasporës me administratën
- Subvencionimi i bizneseve të panairëve vendore dhe ndërkombëtare
- Organizim i fund vitit me biznese lokale donatore bashkëpunëtorë të ndryshëm
- Bashkëpunimi me agjencionet e ndryshme si APRK, AZHR, KIESA, ARBK që ndërlidhen niveli komunal me nivelin qendror.

Sektori: Turizmi

1. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe promovimi i prioriteteve dhe potencialeve të pasurive natyrore/nëntokësore të komunës.
2. Promovimi i potencialeve për zhvillimin e turizmit;
3. Vazhdimi i Shënjestërimit të shtigjeve malore për ecje dhe digjitalizimi i tyre;
4. Bashkëpunime me donatore për Realizimin e projekteve të turizmit;

Investimet Kapitale

- *Ndërtimi i tregut të gjelbër në Kamenicë*
- *Mbarëvajtja e projektit të qendrës zejtare- Procedurat e dhënies në shfrytëzim të lokaleve për bizneset që merren me zejtari.*
- *Përgatitja e thirrjes publike për bashkëfinancim të adaptimit të objekteve komunale të pashfrytëzuara në bujtinave malore*
- *Lugu i verdhë*
- *Parku i aventurave*

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

Zhvillimi Ekonomik:

- *Takime me investitorë potencial, pjesëmarrja dhe promovimi i komunës në panaire të ndryshme*
- *Takime me organizata vendore dhe ndërkombëtare për mundësit e bashkëpunimit në projektin e praktikës profesionale*
- *Mbikëqyrja mbi mbarëvajtjen e parkut teknologjik, bashkëpunimi me biznese/OJQ, për funksionalizimin e Parkut Teknologjik*
- *Bashkëpunimi me drejtorinë për pronë për përpilimin e pronave të lira komunale për shfrytëzim*
- *Monitorimi për zbatimin e objektivave për implementimin dhe zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal*
- *Mbështetja e bizneseve përmes granteve, trajnimeve, bashkëpunimeve me donatore në forma të ndryshme*
- *Bashkëpunimi me DKRS dhe DB për organizimin e ditëve të Diasporës*
- *Ofrimi i kushteve për pjesëmarrjen e bizneseve në panairin e promovimit të produkteve vendore*
- *Linjë e gjelbër për biznese të diasporës- Pako për diasporë*
- *Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për financimin e pjesëmarrjes të bizneseve në panaire të ndryshme*
- *Mbledhja e donatoreve, qeverisë organizatave të ndryshme bashke me bizneset tona në eventin e fund vitit*
- *Rritjen e pjesëmarrjes së grave, të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në tregun e punës;*
- *Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve të punësimit dhe zgjerimin e shërbimeve të aftësisimit profesional.*
- *Organizimi i sesioneve informuese për thirrjet e ndryshme të komunës dhe ministrive të ndryshme;*
- *Nxitja e investimeve përmes avancimit të politikave, rregullatorit, rritjes së kapaciteteve të prodhimit dhe përpunimit në sektorët prioritar industrial, si dhe rritjes së hapësirës së zonave ekonomike;*
- *Gjenerimi i punësimit gjithëpërfshirës dhe më të mirë;*
- *Lehtësimi i industrisë së gjelbër dhe qarkore;*
- *Rritja e Inovacionit në Ndërmarrësi;*

Tabela17. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2026 - 2028

	DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DIASPORË (48029)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	62,856.00	70,000.00	70,000.00	70,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	42,000.00	30,000.00	20,000.00	35,000.00
3.	Subvencionet	170,000.00	155,000.00	65,000.00	85,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	5,000.00			
	TOTALI	279,856.00	255,000.00	155,000.00	190,000.00
	Numri i stafit	7	7	8	8
	Burimet e financimit				
	Granti qeveritar	199,856.00	190,000.00	90,000.00	130,000.00
	Te hyrat vetanake	80,000.00	65,000.00	65,000.00	60,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Edon Dermaku,

Drejtore i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë

Drejtoria për Pronë Kadaster dhe Gjeodezi

Misioni

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi ka për mision ofrimin e shërbimeve profesionale, efikase dhe transparente në fushën e administrimit të pronës, kadastrës dhe gjeodezisë, duke siguruar regjistrim të saktë të pronës së paluajtshme, menaxhim të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtje të pronës publike e private. Përmes zhvillimit të sistemeve moderne kadastrale dhe digjitalizimit të të dhënave, drejtoria synon rritjen e sigurisë juridike për qytetarët, reduktimin e kontesteve pronësore dhe lehtësimin e procedurave administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtoria angazhohet në mirëmbajtjen dhe azhurnimin e regjistrave kadastralë, evidentimin e emërtimeve të vendbanimeve, rrugëve, shesheve dhe numrave të objekteve, si dhe në zhvillimin e rrjeteve referuese dhe sistemeve informative mbi tokën dhe pronën. Gjithashtu, ajo siguron realizimin e procedurave për regjistrimin e pronës, eksproprijimin, vlerësimin e pronës, menaxhimin e tokës komunale dhe mbrojtjen e pronës publike nga uzurpimet.

Në kuadër të funksionimit të saj, Drejtoria realizon të gjitha procedurat në bazë të kërkesave dhe vendimeve të institucioneve kompetente, përfshirë gjykatat, noterët dhe gjeodetët e licencuar, duke vepruar përmes Sistemit Informativ Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK), i cili garanton ligjshmëri, transparencë dhe pamundëson kryerjen e shërbimeve jashtë sistemit zyrtar.

Për vitin në vijim, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi synon realizimin e objektivave konkrete, ndër të cilat janë përfundimi i procesit të numërtimit të objekteve në territorin e komunës, kontrollimi dhe përmirësimi i emërtimeve të rrugëve, si dhe adresimi i kërkesave të qytetarëve dhe lokaliteteve për korrigjimin e gabimeve ekzistuese, me qëllim të përmirësimit të evidencës adresare dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve për qytetarët.

Situata aktuale:

Situata aktuale në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi karakterizohet me funksionalizim të qëndrueshëm të shërbimeve kadastrale dhe pronësore, duke ofruar shërbime efikase dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për qytetarët dhe institucionet komunale. Gjatë vitit 2025, drejtoria ka arritur të realizojë me sukses një numër të konsiderueshëm të procedurave administrative dhe teknike, përfshirë regjistrimin dhe azhurnimin e pronave, trajtimin e kërkesave për bartje prone, evidentimin dhe përmirësimin e të dhënave kadastrale, si dhe digjitalizimin dhe përditësimin e planeve dhe evidencave kadastrale.

Ndër të arriturat kryesore të vitit 2025 përfshihen avancimi i procesit të numërtimit të objekteve në territorin e komunës, përmirësimi i evidencës së adresave dhe emërtimeve të rrugëve, rritja e efikasitetit në trajtimin e lëndëve, si dhe vazhdimi i azhurnimit të bazës së të dhënave në Sistemin Informativ Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK). Gjithashtu, drejtoria ka bashkëpunuar me institucionet relevante në realizimin e procedurave të eksproprijimit, regjistrimit të pronës komunale dhe mbrojtjes së pronës publike nga uzurpimet.

Sa i përket implementimit të objektivave të KASH 2026–2028, drejtoria ka filluar planifikimin dhe harmonizimin e aktiviteteve me prioritetet strategjike komunale, duke u fokusuar në modernizimin e shërbimeve kadastrale, përmirësimin e infrastrukturës së të dhënave pronësore, rritjen e transparencës institucionale dhe avancimin e shërbimeve elektronike për qytetarët. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar përmirësimit të menaxhimit të pronës komunale dhe rritjes së sigurisë juridike në fushën e pronës.

Megjithatë, gjatë realizimit të objektivave janë paraqitur edhe sfida të ndryshme, si mungesa e stafit profesional në disa sektorë, numri i madh i kërkesave dhe lëndëve administrative, çështjet e pazgjidhura pronësore ndër vite, mungesa e dokumentacionit të plotë për raste të caktuara, si dhe nevoja për investime shtesë në pajisje teknologjike dhe digjitalizim të avancuar. Sfidë tjetër mbetet edhe harmonizimi dhe korigjimi i emërtimeve të rrugëve dhe adresave në të gjitha lokalitetet e komunës, për shkak të kërkesave të shumta nga qytetarët dhe ndryshimeve në terren.

Pavarësisht sfidave, Drejtoria për Kadastrë, Gjeodezi dhe Pronësi mbetet e përkushtuar në realizimin e objektivave të planifikuara, duke synuar ofrimin e shërbimeve më cilësore, rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të administrimit të pronës dhe kadastrës në komunë.

Objektivat Kryesore :

- *Shqyrtimi dhe trajtimi me prioritet i kërkesave të bartura nga fundviti 2025, në përputhje me afatet ligjore.*
- *Rilevimi dhe rregullimi i çështjeve pronësoro-juridike të objekteve publike në Komunën e Kamenicës (shkolla, ambulanca, objekte sportive, zyra të vendit etj.).*
- *Mirëmbajtja dhe azhurnimi i të dhënave kadastrale për pronat e evidentuara në fletëposedim në ZK-Kamenicë.*
- *Trajtimi i rasteve të uzurpimit të pronës publike dhe shoqërore.*
- *Realizimi i matjeve në terren për nevoja komunale dhe ofrimi i shërbimeve administrative për qytetarët.*
- *Regjistrimi i pronave në RDPP (Regjistrimi i të drejtes së pronës së paluajtshme), përfshirë hipotekat, barrët tatimore, servitutet, ndër mjetësimet, vërejtjet, përmbaruesit dhe masat e përkohshme nga gjykata.*
- *Zhvillimi i procedurave të shpronësimit për realizimin e projekteve komunale dhe infrastrukturës rrugore.*
- *Përgatitja e lëndëve dhe materialeve për shqyrtim në Kuvendin Komunal lidhur me pronat komunale dhe ato me interes publik.*
- *Evidentimi i pronave të shpronësuara dhe të kompensuara sipas projekteve komunale.*
- *Rregullimi i çështjeve pronësore për pronat e regjistruara në emër të titullarëve inekzistent dhe objekteve të trashëguara institucionale.*
- *Vazhdimi i procedurave për shpronësimin e pronave private për realizimin e projekteve me interes publik në komunë.*

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

- Trajtimi i kërkesave të bartura nga viti 2025 në Sistemin Informativ Kadastral të Kosovës (SIKTK) dhe respektimi i afateve ligjore.
- Verifikimi në terren dhe kompletimi i dokumentacionit pronësor për objektet publike komunale.
- Azhurnimi i të dhënave kadastrale dhe përditësimi i fletëposedimeve në ZK-Kamenicë.
- Identifikimi dhe trajtimi administrativ i rasteve të uzurpimit të pronës publike dhe shoqërore.
- Kryerja e matjeve gjeodezike dhe ofrimi i shërbimeve administrative për qytetarët.
- Regjistrimi në RDPP i pronave, hipotekave, barrëve tatimore, servituteve dhe vendimeve gjyqësore.
- Zhvillimi i procedurave të shpronësimit për projekte rrugore dhe projekte tjera komunale.
- Përgatitja e materialeve dhe lëndëve për shqyrtim në Kuvendin Komunal.
- Evidentimi dhe azhurnimi i pronave të shpronësuara dhe të kompensuara sipas projekteve komunale.
- Rregullimi i regjistrave pronësorë për pronat e evidentuara në emër të institucioneve apo titullarëve inekzistent.

Koordinimi me institucionet relevante për realizimin e projekteve me interes publik dhe procedurave pronësore

Tabela18. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027- 2029

	SHËRBIMET KADASTRALE (65145)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	116,629.00	124,000.00	115,000.00	125,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	10,000.00	8.000.00	5,000.00	5,000.00
3.	Komunalitë	-			
4.	Shpenzimet kapitale	-			
	TOTALI	126,629.00	132,000.00	120,000.00	130,000.00
	Numri i stafit	12	12	12	12

Informata mbi Udhëheqësin:

Burbuqe Leka,

Drejtore e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapesinor

Misioni:

Misioni i drejtorise se Urbanizmit dhe Planifikimit Hapesinor eshte te orientoj dhe mbaje nen kontrolle zhvillimin hapesinore ne teritorin e komunes se Kamenices, duke bere hartimin e dokumenteve te planifikimit hapesinor, zbatimin e tyre gjate trajtimit te kerkesave per leje ndertimore, si dhe te zhvilloj/permiresoj infrastrukturen teknike dhe sociale permes planifikimit, zbatimit dhe kontrollimit te zhvillimit hapesinor te tyre.

Situata aktuale:

Duke pasur parasysh planifikimet buxhetore te viteve te kaluara ne DUPH kemi kete situatë:

- Gjate vitit 2025 kemi perfunduar PZHK-në, per kete kemi angazhuar konsulent/ekspertët te jashtëm te planifikimit hapësinor.
- Sa i perket Hartes Zonale, kemi draftuar HZK-ne dhe do te vazhdojme edhe gjate ketij viti te punojme per hartimin e dhe marjen e miratimit nga MMPH.
- Nuk kemi mundur te vazhdojme me hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, per shkak qe sipas ligjit te planifikimit hapesinor, se pari hartohet HZK, pastaj vazhdohet ne hartim te Planeve te Hollësishme.
- Kemi bere menaxhimin e disa kontratave të investimeve kapitale, ku kemi angazhuar edhe inzhinjeret e DUPH-së, per menaxhim te projekteve.

-PROJEKTET AKTUALE NËN PËRGJEGJËSINË E DUPH:

-Riparimi i fasades se demtuar pas rrenimit te objektit te kadastres se vjeter Projekt në realizim.

VIZIONI: per te ardhmen eshte te mbaje nen kontrolle zhvillimin hapesinor ne teritorin e komunes se Kamenices, duke bere zbatimin e dokumenteve te planifikimit hapesinor, si dhe planifikimin dhe kontrollimin e zhvillimit hapesinor te Komunes se Kamenices.

Ky vizion synohet te arrihet permes 3 objektivave kryesore per vitet 2026-2029:

- a) Kompletimi i dokumenteve te planifikimit hapesinor per teritorin e Komunes se Kamenices
- b) Permiresimi i infrastruktures teknike dhe sociale permes investimeve kapitale
- c) Permiresimi i sherbimeve ne DUPH

Aktivitetet:

- a) Kompletimi i dokumenteve te planifikimit hapesinor per teritorin e Komunes se Kamenices, do të realizohet përmes këtyre aktiviteteve:
Keto dokumente planifikojme ti hartojme permes angazhimit te ekspertëve të jashtëm, gjate viteve 2026,2027,2028,2029

Tabela19. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPSINOR	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	87,783.00	95,000.00	90,000.00	90,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	50,000.00	45,000.00	40,000.00	60,000.00
3.	Shpenzimet kapitale				
	TOTALI	137,783.00	140,000.00	130,000.00	150,000.00
	Numri i stafit	10	10	10	10
	Burimet e Financimit				
	Granti qeveritar	127,783.00	125,000.00	115,000.00	15,000.00
	Te hyrat vetanake	10,000.00	15,000.00	15,000.00	135,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Uran Berisha,

Drejtore i Drejtorisë për Urbanizëm,

Drejtoria e Investimeve Kapitale

Deklarata e Misionit:

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

1. Harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale;
2. Përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore;
3. Përgatit detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës lokale dhe rurale.

Deklarata e qëllimit:

1. Harton projektet e vogla të infrastrukturës, sipas kërkesave të bashkësive lokale;
2. Lëshon leje për ndërtim (të infrastrukturës rrugore) dhe leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike, si dhe leje për kyçe individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës;
3. Është përgjegjëse për menaxhimin (mbikëqyrjen) e ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kabllore, ujësjellësin, asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal) në qytet dhe vise rurale;
4. Kontrollon dhe mbikëqyrë cilësinë dhe ngjeshmërinë e materialit ndërtimor, nëpërmjet laboratorit të licencuar për përputhshmërinë me norma teknike të pranuara në nivel ndërkombëtar dhe të BE;
5. Bashkëpunon me organin e prokurimit, me qëllim të jetësimit të kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve të infrastrukturës lokale;
6. Kryen punë nga lëmi i gjeodezisë për nevoja të Drejtorisë;
7. Ruan dokumentacionin e eksproprijimit të pronave gjatë viteve të mëhershme që janë në interes të Komunës;
8. Arkivon dokumentacionin teknik të infrastruktures Komunale.

Objektivat Kryesore :

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka: -

1. harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale; -
2. përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore; -
3. përgatit detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës lokale dhe rurale.

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

1. Harton projektet e vogla të infrastrukturës, sipas kërkesave të bashkësive lokale;
2. është përgjegjëse për menaxhimin (mbikëqyrjen) e ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kabllore, ujësjellësin,

asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal) në qytet dhe vise rurale;

3. kontrollon dhe mbikëqyrë cilësinë dhe ngjeshmërinë e materialit ndërtimor, nëpërmjet laboratorit të licencuar për përputhshmërinë me norma teknike të pranuar në nivel ndërkombëtar dhe të BE;
4. bashkëpunon me organin e prokurimit, me qëllim të jetësimit të kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve të infrastrukturës lokale;
5. kryen punë nga lëmi i gjeodezisë për nevoja të Drejtorisë;

Propozimet për Politika të reja 2026-2028

	Projektet	Vlera e parashikuar
1	"Hartimi i projektit kryesor për zgjerimin e rrugës R123 – Qendra Kamenicë – R.7.1 në kycje të Dheut të Bardhë të Tjegulltorja."	13,000,000.00
2	Vazhdimi i Brezit Kufitar	5,000,000.00
3	Rehabilitimi i rrugës kryesore në lagjen Malesia	2,000,000.00
4		

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në edhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2026. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Organizatat buxhetore duhet të marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2027-2029. Andaj Drejtori të caktuara duhet të paraqesin të dhënat nga tabelat më poshtë.

Viti	Nr. total istafit	Nr. i stafit femra	Nr. i stafit meshkuj	Paga dhe mëditje/ për femra	Paga dhe mëditje/ për meshkuj	Totali
2026	15	7	8			
2027	18	8	10			
2028	20	10	10			

Planifikimi për vitin 2026-Nivelet e pagave ne Organizatën Buxhetore (Drejtori)

Nivelet e pagave	Numri total i stafit në nivele të pagave	Meshkuj	Shuma e shpenzuar për meshkuj	Femra	Shuma e shpenzuar për femra
201-400	/	/		/	

401-600		3		3	
600+		5		4	
TOTALI	15	8		7	

Tabela20. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	DREJTORIA INVESTIMEVE KAPITALE (66650)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	85,177.00	67,000.00	67,000.00	67,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	70,000.00	55,000.00	40,000.00	55,000.00
3.	Shpenzimet kapitale	1,292,792.00	1,270,792.00	700,000.00	950,000.00
	TOTALI	1,417,969.00	1,392,792.00	807,000.00	1,072,000.00
	Numri i stafit	7	7	7	7
	Burimet e Financimit				
	Granti qeveritar	995,609.00	1,072,792.00	510,974.00	746,528.00
	Te hyrat vetanake	422,360.00	320,000.00	296,,026.00	325,472.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Blerim Morina,

Drejtor i Drejtorisë për Investime Kapitale

Tabela 21. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	ADMINISTRATA SHENDETSI (73038)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	34,508.00	40,000.00	40,000.00	42,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	40,000.00	40,000.00	35,000.00	30,000.00
3.	Shpenzime Komunale	-			
4.	Shpenzimet kapitale	60,000.00			
	TOTALI	134,508.00	80,000.00	75,000.00	72,000.00
	Numri i stafit	4	4	4	4
	Burimet e Financimit				
	Granti Qeveritar		65,000.00	55,000.00	52,000.00
	Te hyrat vetanake		15,000.00	20,000.00	20,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Besart Kryeziu,

Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale

Qendra Komunale e Mjeksisë Familjare(QKMF)

Misioni:

Misioni i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është:

Sigurimi i zbatimit të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) në nivel lokal, duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese, nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, si dhe brenda synimeve të politikave shëndetësore, të siguroj ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative, mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel komunal, si dhe përkujdesjen për mirëqenie sociale të kategorive të caktuara të popullatës së saj.

Objektivat

Sigurimi i shëndetit sa ma të mirë për të gjithë qytetaret e Komunes Së Kamenicës, përmes një sistemi shëndetësor ma efikas brenda resurseve humane e materiale të disponueshme:

- Përmirësimi i infrastruktures
- Sigurimi i aparatures
- Materiale adekuate
- Ngritja e resurseve humane

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

- Përmirësimi i shëndetit të të rinjve vajzave dhe djemve
- Përmirësimi i shëndetit mendor --
- Zhvillimi i potencialit njerzor –
- Zvoglimi i smundjeve ngjitëse dhe kronike –
- Prezentimi i reformave institucionale dhe përmirësimi i praktikës menagjuese në sistemin shëndetsor –
- Zhvillimi i sistemit informativ shëndetsor –
- Përmirësimi i shërbimeve emergjente dhëndetsore dhe parapregaditja për situata emergjente në sektorin Shëndetsor.
- Paisje me aparaturë shëndetsore adekuate si: (aparaturë ultrazëri,EKG-e,aparaturë për laborator,defibrilator,karrika stomatologjike etj. Përmirësimin e barazisë gjinore në mesin e stafit në secilin departament dhe në të gjitha nivelet
- Përmirësimin e barazisë gjinore në të gjitha format e shërbimeve të ofruara për të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

Tabela22. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	QKMF (74755)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	1,673,499.00	1,842,000.00	1,732,000.00	1,772,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	344,023.00	240,000.00	130,000.00	160,000.00
3.	Komunalitë	32,000.00	34,002.65	33,000.00	35,000.00
4.	Subvencione	-			
5.	Shpenzimet kapitale	-			
	TOTALI	2,049,522.00	2,116,002.65	1,895,000.00	1,917,000.00
	Numri i stafit	165			
	Burimet e financimit				
	Granti qeveritar	2,019,522.00	2,086,002.65	1,865,000.00	1,887,000.00
	Te hyrat vetanke	30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Latif Sylaj,

Drejtor i QKMF-së

Qendra për Punë Sociale

Misioni:

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në kuadrin e saj ka tre sektor:

1. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
2. Qendra për Punë Sociale dhe
3. Shërbimet Sociale Rezidenciale – Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore.

Qendra për Punë Sociale përbëhet nga:

- **Spektori i Shërbimeve Sociale** i cili merret me ofrimin e shërbimeve të ndryshme sociale në gjithë territorin e komunës dhe për të gjitha komunitetet.
- **Spektori i Asistencës Sociale** i cili merret me përzgjedhjen dhe vlerësimin e familjeve dhe individëve në nevojë për asistencë sociale-materiale në gjithë teritorin e komunës dhe të gjitha komunitetet.

Situata Aktuale

- Qendra për Punë Sociale ka përmbushur objektivat dhe qëllimet sipas planifikimit të buxhetit, duke shpenzuar në tërësi buxhetin e paraparë. QPS-e ka stafin e mjaftushëm profesional në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve sipas ligjit për ofrimin e shërbimeve të ndryshme ndaj qytetareve.
1. Shërbimet për të gjitha kategoritë e fëmive, fëmijë pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar/neglizhuar, me vështirësi në sjellje, në konflikt me ligjin, me nevoja të veçanta, në situatë rrugë, në punë të rënda dhe të rëzikshme, etj.
 2. Shërbimet si kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial, adoptimi.
 3. Kategoria e personave të moshuar pa përkujdesje
 4. Çrregullimi i mardhënieve bashkëshortore
 5. Dhuna në familje
 6. Kontaktet fëmijë-prind.
 7. Aftësia e kufizuar (fëmijë dhe të rritur)
 8. Lëshimin e 5 lloje të vërtetimeve, konstatime dhe pëlqime
 9. Spektori i ndihmave sociale (menaxhimi me skemat sociale si kategoria I dhe II, Pilot skema, etj,
 10. Spektori i administratës dhe financave (punët administrative dhe financiare)

Tabela 23. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	QENDRA PËR PUNË SOCIALE (75641)	2025 Shpenzimi	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje		114,952.00	120,000.00	120,000.00	120,000.00
2.	Mallra dhe shërbime		20,000.00	15,000.00	20,000.00	25,000.00
3.	Subvencione					
4.	Shpenzime Kapitale					
	TOTALI		134,952.00	135,000.00	140,000.00	145,000.00
	Stafi	12				
	Burimet e Financimit					
	Granti Qeveritar			135,000.00	140,000.00	145,000.00
	Te hyrat vetanake					

Objektivat Kryesore :

- Ofrim i shërbimeve cilësore për qytetarët në nevojë, sipas standardeve minimale të cilësisë
- Ambient dhe kushte të përshtatshme pune për zyrtarët e drejtorisë
- Shpërblime meritore për punën dhe angazhimin profesional për stafin e drejtorisë

Objektivat e mësipërme të Drejtorisë do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve :

- Themelimi i Fondit Emergjent për Viktimat e Dhunës në Familje dhe Dhunës në Baza Gjimore
- Subvencionimi i qirasë për viktimat e dhunës në familje dhe kategori të tjera sociale në nevojë
- Subvencionimi i familjeve strehuese
- Kontraktimi i shërbimeve sociale me ofrues të licencuar
- Pagesa për shpenzime gjyqësore
- Kompletim i stafit profesional për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare
- Rinovimi i brendshëm i objektit të QPS
- Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare dhe furnizimi i rregullt me derivate
- Furnizim me pajisje elektronike dhe material për zyre
- Furnizim me mallra për mirëmbajtje/pastrim të ambientit

Tabela 1, Buxheti gjinor

Viti	Numri total i stafit	Numri i stafit që janë gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/shuma për gra	Paga dhe mëditje/shuma për burra	TOTALI
2023						
2024						
2025						
2026						
2027						

Tabela: Planifikimi-Nivelet e pagave ne Sherbime Sociale, struktura gjinore

Nivelet e pagave	Numri total i stafit në nivele të pagave	Numri i burrave	Shuma e shpenzuar për burra	Numri i Grave	Shuma e shpenzuar për gra
201-400					
401-600	3	2	18,218.88	1	13,200.00
600+	9	4	52,709.04	5	52,200.00
TOTALI					

Shërbimet Rezidenciale

1.Misioni:

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në kuadrin e saj ka tre sektor:

1. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
2. Qendra për Punë Sociale dhe
3. Shërbimet Sociale Rezidenciale.

Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore sipas Marrëveshje në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Kamenicës nga Janari 2016 ka kaluar nën menaxhimin e Komunës, gjegjësisht nën ambrellën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Shtëpia e Komunitetit është një institucion rezidencial, në të cilin janë të vendosur 12 persona (rezidentë) me aftësi të kufizuara mendore me qëndrim 24 orë. Shtëpia e Komunitetit sipas rregullorës së punës është e obliguar t'i përmbush të gjitha nevojat rreth përkujdesjes të përgjithëshme të rezidentëve të saj, duke filluar nga përkujdesja shëndetësore, ushqimi, hixhena, akomodimi, veshmbathja, puna okupuese dhe rehabilituese, integrimi i tyre në shoqëri etj.

2.Situata aktuale:

Institucioni ka për obligim dhe prioritet mirqenien e rezidentëve të vendosur në institucion për një jetë sa më të dinjitetëshme, humane dhe integruese në jetën e përditëshme.

Personat me aftësi të kufizuara sipas ligjit i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë si qdo qytetar tjerë, andaj institucioni duhet t'i respektoj këto të drejta sipas ligjit të cilat ju takojnë. Viti 2026 ka qenë një vit i sukseshëm, ku kemi përmbushuar detyrat dhe obligimet e parapara, duke shpenzuar buxhetin në përputhje me planifikimet buxhetore. Në këtë mënyrë rezidentëve të vendosur në institucion ju kemi krijuar kushte të mira banimi, ushqimi, fjetje, veshmathje, aktivitete relaksuese dhe trajtimet e nevojshme shëndetësore

1..Objektivat dhe aktivitetet:

Realizimi sa më efikas i të gjitha detyrave dhe obligimeve të punës me të cilat institucioni është i ngarkuar sipas ligjeve, udhëzimit administrativ dhe rregullores për punë në institucionet rezidenciale për aftësinë e kufizuar. Objektiv kryesor është "Mirëqenia e Rezidentëve" të vendosur në institucion, përkujdesja e gjithëanshme e rezidentëve duke ju krijuar një ambient shtëpiak, socializim, rritjen e aftësive për vetëkujdesje dhe puna okupuese -relaksuese.

2.Trendet e financimit 2027 dhe vlerësimet 2028-2029:

Financimi për vitin 2027 është i mjaftushëm për mbulimin e të gjitha kërkesave të institucionit dhe në përputhje me planifikimet e bëra paraprakisht. Sa i përket planifikimit të buxhetit për vitin 2027 kemi nevojë për rritjen e numrit të stafit për një zyrtar në pozitën "Përgjegjës e " në institucion me orar pune nga ora 08.00-16.00, e cila do të kujdeset për punët gjatë ditës në institucion, si trajtimet shëndetësore, terapia e rregullt, barenat, hixhenën etj

3..Propozimet për politika të reja 2027-2029:

Në vitet 2027-2029 Planifikimi i Buxhetit për Shërbimet Sociale Rezidenciale në kategorinë "Paga dhe Meditje " të shtohet shuma **12000.00** (dymbdhjetë mijë euro me qëllim të rekrutimit të një zyrtari shtesë në shërbimet rezidenciale në Kamenicë, kodi 75642. Po ashtu kemi nevojë në rritjen e shërbimeve komunale për vitet pasuese, sepse gjatë këtij viti kemi planifikuar vendosjen e pompës termike, ku do të shtohen shpenzimet e energjisë elektrike.

Objektivat Kryesore : 1.Sigurimi i kushteve për përkujdesjen dhe mirëqenien e përgjithëshme të rezidentëve 2. Përkujdesja ndaj ambientit të përgjithshëm të rezidentëve 3. Ofrimi i shërbimeve të nevojshme shëndetësore 4. Rehabilitimi dhe integrimi i tyre në shoqëri - komunitet 1.-Objektivat e mësipërme (Përkujdesja dhe mirëqenia e rezidentëve) do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve: 1.Sigurimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin e jetës normale të rezidentëve (hapsira e nevojshme,zhvillimi i aktiviteteve okupuese dhe relaksuese). 1.a: pregaditja e rregullt e ushqimit - mirëmbajtja e kuzhines në përgjithësi 1.b. Mirembajtja e hixhenes personale te rezidenteve 1.c. Akomodimi dhe veshmbathja e tyre 1.d. Pastrimi personal te rezidenteve 1.e.Aktivitetet ditore -rehabilituese 1.ë. Puna okupuese dhe relaksuese me rezidentet

2.a.Mirëmbajtja e pastertise ne dhomat e rezidenteve 2.b. mirembajtja e hixhenes ne dhomen e dites 2.c. Mirembajtja e parkut të institucionit 2.d. Mirëmbajtja e të gjitha paisjeve të institucionit ne gjendje te rregull.

3. - Objektivi (Ofrimi i shërbimeve të nevojshme shëndetësore) do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve: 3.a. Dhenja e terapive ditore me rregull 3.b. Matja e TA, Pulsit dhe sheqerit,temperaturës 3.c. Dergimi ne kontrollet e rregulta specialistike (neuropsikiatri, neurologu, internisti, pulmologu, gjinekologu, stomatologu, infektologu) 3.d. Kontrollet tjera sipas nevojave dhe emergjencave 3.e. Analizat e pergjitheshme laboratorike 3.ë. Analizat tjera sipas nevojave 3.f. Vaksinat e rregullta kunder virusëve të ndryshëm. 4.- Objektivi (Rehabilitimi dhe integrimi i tyre në shoqëri) do të realizohen përmes këtyre aktiviteteve: 4.a. Organizimi i shetitjeve te ndryshme (shetitje ne parkun e qytetit, organizimi i pikniqeve) 4.b.Organizimi i ekskurzioneve ne vende te ndryshme 4.c. Dergimi i rezidenteve ne rehabilitim. 4.d, Dergimi i rezidenteve në kinema - teatro 4.e. Organizimi i tubimeve te ndryshme ne komunitet (koncerte, shkolla, qerdhe, FSK,)

Tabela 24. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	SHËRBIMET REZIDENCIALE (75642)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	109,579.00	80,000.00	80,000.00	82,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	75,000.00	75,000.00	55,000.00	70,000.00
3.	Shpenzime Komunale	10,000.00	10,000.00	15,000.00	16,000.00
4.	Shpenzimet kapitale	35,000.00	30,000.00	25,000.00	25,000.00
	TOTALI	229,579.00	195,000.00	175,000.00	193,000.00
	Numri i stafit	11	11	11	11

Informata mbi Udhëheqësinë

Ajdin Krivaqa,

Udhëheqës i Shërbimeve Rezidenciale

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Deklarata e Vizionit:

Arritje e një kulture të avancuar dhe moderne, rini të shëndoshë, prosperuese në të gjitha lëmit, gjithëpërfshirëse dhe me rezultate të prekshme.

Deklarata e Misionit:

Përkushtimi permanent ndaj avancimit në lëmin e kulturës, rinisë dhe sporteve, ruajtjen e trashëgimisë dhe vlerave kulturore, sipas kërkesave bashkëkohore që kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave të komunitetit.

Deklarata e Qëllimit:

Arritja e standardeve sa më të larta në sferën e kulturës, rinisë dhe sporteve, vetëdijësim i përgjithshëm për ruajtje dhe prezantim të vlerave tradicionale.

Objektivat:

- **Organizimi i aktivitetit tashmë tradicional Sumerfest,**
- **Financimi i Ojq-ve dhe Klubeve sportive,**
- **Promovimi i diversitetit dhe identitetit:** Mbështetja e krijimtarisë artistike, teatrore, letrare dhe kinematografike për të ruajtur vlerat tradicionale dhe për të nxitur artin bashkëkohor.
- **Trashëgimia kulturore:** Ruajtja, restaurimi dhe promovimi i monumenteve historike, muzeve etj,
- **Promovimi i ideve kreative:** Krijimi i kushteve për nxitjen e ideve kreative dhe fuqizimin e krijuesve të pavarur.
- **Pjesëmarrja aktive:** Angazhim më i madh i të rinjve në vendimmarrje, jetën publike dhe proceset demokratike.
- **Edukimi jo-formal dhe punësimi:** Zhvillimi i programeve që rrisin aftësitë profesionale, ndërmarrësinë dhe zvogëlojnë shkallën e papunësisë te të rinjtë.
- **Sporti masiv dhe shëndeti:** Inkurajimi i qytetarëve, veçanërisht fëmijëve dhe të rinjve, për t'u përfshirë në aktivitete fizike dhe shprehi të shëndetshme jetese.
- **Infrastruktura sportive:** Ndërtimi, renovimi dhe modernizimi i hapësirave sportive (palestra, fusha, qendra) për të krijuar kushte standarde për të gjithë.
- **Cilësia dhe garat:** Mbështetja e sportistëve dhe rritja e kapaciteteve të sportistëve përfaqësues për arritjen e rezultateve.

Tabela 25. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT (85029)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	148,897.00	160,000.00	155,000.00	150,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	70,000.00	60,000.00	50,000.00	60,000.00
3.	Subvencione	110,000.00	70,000.00	30,000.00	65,000.00
4.	Shpenzimet kapitale	36,000.00			
	TOTALI	364,897.00	290,000.00	235,000.00	275,000.00
	Numri i stafit	17			
	Burimet e Financimit				
	Grantet qeveritare	324,897.00	270,000.00	215,000.00	250,000.00
	Te hyrat vetanake	40,000.00	20,000.00	20,000.00	25,000.00

PERKRAHJA E RINISE

Tabela 26. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	PERKRAHJA E RINISE (85069)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	29,144.00	34,000.00	30,000.00	30,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	20,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00
3.	Subvencione	-	10,000.00	20,000.00	20,000.00
4.	Shpenzimet kapitale	20,000.00			
	TOTALI	69,144.00	59,000.00	65,000.00	65,000.00
	Numri i stafit	4			
	Burimet e financimit				
	Grantet qeveritare	63,144.00	39,000.00	35,000.00	55,000.00
	Te hyrat vetanake	6,000.00	20,000.00	30,000.00	10,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Afrim Dervishi,

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,

Drejtoria për Arsim dhe Shkencë

Deklarata e vizionit:

Të sigurojë barazinë e mundësitë për të ndjekur arsimi cilësor për të gjithë nxënësit parashkollor, fillor dhe të mesëm të gjithë qytetarëve të Komunës përfshirë edhe pakicat / minoritetet, të mbështesë zhvillimin dhe aftësimin e personelit, të nxisë bashkëpunimin midis mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore.

DKA orienton të gjithë nën sektorët në aktivitete të tyre të rregullta afatmesme, në planifikimin vjetor, të përkrah, të bashkërendoj, të rregulloj dhe të promovoj arsimin cilësor për të gjithë qytetarët.

DKA do të siguroj një bazë për bashkërenditjen dhe negocimin me agjensitë qeveritare me partnerët zhvillimor dhe me palët tjera kryesore në sektorin e arsimit.

Deklarata e misionit:

Drejtoria për Arsim ushtron funksionet dhe përgjegjësit e saj në bazë të ligjit për arsimin para universitar. Kjo drejtori krijon mundësinë për zhvillimin dhe përkrahjen e një sistemi gjithëpërfshirës arsimor ku siguron qasje të barabarte të gjithë djemve dhe vajzave nga vendbanime të ndryshme të komunes, për arsimin e tyre në institucionin parashkollor, arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës. Gjithashtu krijon kushte dhe u jep mundësi të gjithë mësimdhënësve në aftësimin profesional përmirësimin e performancës, rritjen e kualifikimit etj. DKA kërkon forcimin e mekanizmave të llogaridhënies përmes vlerësimit të performancës. Zbatimi i kurrikules nëpër shkollë, zbatimi i politikave të reja në arsim duke siguruar asistencë tek fëmijet me nevojë të veçanta, zhvillimi i praktikës profesionale, koordinatorët e cilësisë si dhe zbatimin e aktiviteteve tjera.

Deklarata e Qëllimit:

Arritja e standardeve të larta në sferën e arsimit, përfshirja e të gjithë djemve dhe vajzave nga fushat e ndryshme në shkollë ku qëllimet janë në harmoni me objektivat dhe Strategjinë zhvillimore ku përfshihen integritet dhe institucioneve arsimore, zbatimin e programeve të veçanta për parandalimin e braktisjes së shkollës, identifikimi i fëmijëve me nevojë të veçanta si dhe transporti i nxënësve në shkollë.

Tabela 27. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	ADMINISTRATA ARSIM (92145)	2026	2027	2028	2029
		Aktuali	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	341,362.00	64,125.00	65,000.00	65,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	65,000.00	629,875.00	382,765.00	409,815.00
3.	Shpenzime Komunale	-	70,000.00	70,000.00	70,000.00
4.	Subvencione		100,000.00	80,000.00	90,000.00
5.	Shpenzimet kapitale	-	40,000.00		
	TOTALI	406,362.00	904,000.00	597,765.00	634,815.00
	Numri i stafit	51	51	51	51
	Burimet e financimit				
	Grantet qeveritare	386,362.00	704,000.00	265,000.00	344,815.00
	Te hyrat vetanake	20,000.00	200,000.00	332,765.00	290,000.00

Tabela 28. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	ARSIMI PARAFILLOR (92770)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	341,362.00	368,000.00	370,000.00	370,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	65,000.00	55,000.00	50,000.00	60,000.00
3.	Shpenzime Komunale	-			
4.	Subvencione				
5.	Shpenzimet kapitale	-			15,000.00
	TOTALI	406,362.00	423,000.00	420,000.00	445,000.00
	Numri i stafit	51	51	51	51
	Burimet e financimit				
	Grantet qeveritare	386,362.00	408,000.00	410,000.00	425,000.00
	Te hyrat vetanake	20,000.00	15,000.00	10,000.00	20,000.00

Tabela 29. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 – 2029

	ARSIMI FILLOR (93840)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	4,004,081.00	4,115,000.00	4,100,000.00	4,110,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	90,000.00	70,000.00	60,000.00	70,000.00
3.	Shpenzime Komunale	-			
4.	Shpenzimet kapitale	-			
	TOTALI	4,094,081.00	4,185,000.00	4,160,000.00	4,180,000.00
	Numri i stafit	458	463	463	463
	Burimet e financimit				
	Granti qeveritar	4,091,381.00	4,170,640.00	4,145,000.00	4,160,000.00
	Te hyrat vetanake	2,700.00	14,360.00	15,000.00	20,000.00

Tabela 30. Performanca: Kufijtë e Shpenzimeve: 2027 - 2029

	ARSIMI I MESEM I LARTE(95040)	2026 Aktuali	2027 Vlerësuar	2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
1.	Paga dhe mëditje	1,382,717.00	1,290,000.00	1,270,000.00	1,280,000.00
2.	Mallra dhe shërbime	51,761.00	40,000.00	40,000.00	40,000.00
3.	Shpenzime Komunale	-			
4.	Shpenzimet kapitale	-			
	TOTALI	1,434,478.00	1,290,000.00	1,310,000.00	1,320,000.00
	Numri i stafit	151	144	144	144
	Burimet e Financimit				
	Granti qeveritar	1,424,478.00	1,260,000.00	1,275,000.00	1,290,000.00
	Te hyrat vetanake	10,000.00	30,000.00	35,000.00	30,000.00

Informata mbi Udhëheqësin:

Selami Klaiqi,

Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

PROGRAMI KOMUNAL I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP)

Vlerësimi i Kapaciteteve Investuese

Është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financim të zbatimit të Planeve Zhvillimore, si dhe drejtimin të Investimeve Kapitale Publike.

Komunat në Republikën e Kosovës, kanë rol qendror në caktimin e prioriteteve të investimeve kapitale dhe në aranzhimin e investimeve lokale përmes mekanizmave të cilat i kanë në dispozicion. Kjo mund të përfshijë gjenerimin e të hyrave lokale, vjeljen e taksave dhe tarifave, zhvillimin e partneriteteve publike-private, aranzhimin e ndarjes së drejtë të projekteve kapitale me projeksione sipas formulës shtetore.

Komunat kanë një rol gjithnjë e më të vetëdijshëm se investitorët ndërkombëtarë dhe të brendshëm, huadhënësit dhe agjencitë kreditore i konsiderojnë qeveritë lokale si klientë të mirë për biznes, me kusht që ato ti ndjekin praktikën e mira të afarizmit, dhe rritjen e nivelit të performancës.

Kryetari i Komunës së bashku me Kuvendin Komunal si organ legjislativ dhe Komiteti për Politikë dhe Financa janë përgjegjës për përgatitjen e buxhetit, i cili përfshinë programin e investimeve kapitale dhe buxhetin.

Draft Propozimi i Programit Komunal për Investime Publike në masë të duhur merr parasysh kërkesat – propozimet fillestare të Drejtorive komunale (Programeve buxhetore) – Projektet e propozuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2027 / 2029 sipas proceseve buxhetore të zhvillohen këtë vit.

Sipas vlerësimeve të shpenzimeve totale buxhetore - investimet kapitale për vitin 2027 të mbetura pas zbritjes së shpenzimeve të pagave, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale dhe subvencioneve të paraqitura, atëherë për investime kapitale për vitin 2027 mbetet shuma prej 1,750,792.00 € nga buxheti total i Komunës për vitin 2027.

*Ndërsa për vitin 2028 mbetet shuma **875,000.00 €** për shpenzimet kapitale dhe për vitin 2029 shuma prej **1,175,000.00 €**, derisa Kërkesat e Drejtorive janë shumë më të mëdha se sa që ofrojnë limitet buxhetore sipas Qarkores së parë Buxhetore nr. 2027/01, të MFPT-së për Komunën e Kamenicës për periudhën: 2027 - 2029, ashtu sic do të shihet edhe në tabelën e Investimeve kapitale, e cila i bashkëngjitet këtij KAB-i.*

Pra, sic shihet, projeksionet e ardhshme paraqesin një shkurtim buxhetor, por le të themi se janë vetëm vlerësime, sepse do të shënonte një regres në investime në raport me vitet e fundit, gjë që do të keqsonte gjendjen ekonomike edhe ashtu të rënduar.

**Kamenicë,
Qershor 2026**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa